

**Profili i Sistemit të Sigurisë Sociale në Kosovë  
(sipas Rezolutës 1244 [1999] të KS të OKB-së)**

E drejta e Autorit © Zyra Ndërkombëtare e Punës 2010  
Botuar për herë të parë 2010

Botimet e Zyrës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të Drejtën e Autorit sipas Protokollit 2 të Konventës Universale të së Drejtës Autoriale. Megjithatë, fragmente të shkurtra prej tyre mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të përmendet burimi. Për të drejtat e riprodhimit apo përkthimit, duhet aplikuar pranë ZNP Botime (të drejtat dhe lejet), Zyra Ndërkombëtare e Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër, ose me email: [pubdroit@ilo.org](mailto:pubdroit@ilo.org). Zyra Ndërkombëtare e Punës i mirëpret kërkesat e tilla.

Bibliotekat, institucionet dhe përdorues të tjerë të regjistruar nga organizata me të drejta riprodhimimund të bëjnë kopje në pajtim me licencat lëshuar atyre për këtë qëllim. Vizito [www.ifrro.org](http://www.ifrro.org) për informata në lidhje me organizatat për të drejtat e riprodhimit në vendin tënd.

---

Profili i sistemit të sigurisë sociale në Kosovë (sipas definimit të Rezolutës 1244 të KSKB [1999])/ International Labour Office, ILO Sub-Regional Office in Budapest - Budapest: ILO, 2010  
1 v.

ISBN: 9789228233582; 9789228233599 (web pdf)

Poashtu në dispozicion:

versioni në gjuhën angleze, Profile of the social security system in Kosovo (within the meaning of UNSC Resolution 1244 [1999]), ISBN 9789221233589; 9789221233596 (web pdf), Budapest, 2010

versioni në gjuhën serbe, Profil sistema socijalne zastite na Kosovu (u saglasnosti sa definicijom Rezolucije SBUN [1244]), ISBN 9789228233605; 9789228233612 (web pdf), Budapest, 2010

International Labour Office

social security / pension scheme / medical care / Serbia

02.03.1

*ILO Cataloguing in Publication Data*

---

Përcaktimet e përdorura në Botimet e ZNP-së, që janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, si dhe prezantimi i materialit, nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinionit nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, zone apo territori apo të autoriteteve të tyre respektive, apo në lidhje me vendosjen e kufijve të tij.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt, studimet, apo kontributet e tjera të nënshkuara qëndron vetëm tek autorët e tyre, dhe botimi nuk përbën përkrahje nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës të opinioneve të shprehura në to.

Referencat ndaj emrave të firmave dhe produkteve e proceseve komerciale nuk përbën përkrahje të tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe mospërmendja e ndonjë firme të vecantë, produkti apo procesi komercial nuk është shenjë mosaprovimi.

Botimet e ZNP-së mund të merren përmes librashitësve të fuqishëm apo në zyrat lokale të ZNP-së në shumë vende, ose drejtëpërdrejtë nga Departamenti i Botimeve të ILO-s, Zyra Ndërkombëtare e Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër. Katalogjet apo listat e publikimeve të reja janë të disponueshme falas në adresën e mësipërme, ose me email [pubvente@ilo.org](mailto:pubvente@ilo.org).

Vizitoni faqen tonë të internetit: [www.ilo.org/publns](http://www.ilo.org/publns)

---

Shtypur në Kosovë

---

# Përmbajtja

## Hyrje

<b>1</b>	<b>Konteksti demografik, ekonomik dhe social .....</b>	<b>6</b>
1.1	Pasqyrë .....	6
1.2	Situata makroekonomike.....	6
1.3	Trendët demografike .....	7
1.4	Tregu i punës .....	9
1.5	Ekonomia informale .....	11
1.6	Varfëria .....	11
1.7	Sistemi i arsimit .....	13
1.8	Puna e fëmijëve .....	16
1.9	Statusi shëndetësor .....	18
<b>2</b>	<b>Sistemet e sigurimit social në Kosovë .....</b>	<b>20</b>
2.1	Sistemet e pensioneve .....	20
2.1.1	Pasqyrë .....	20
2.1.2	Sistemi i pensionit bazë – shkalla e parë .....	21
2.1.3	Kursimet pensionale të obligueshme – shkalla e dytë .....	23
2.1.4	Sistemi pensional vullnetar – shkalla e tretë .....	26
2.1.5	Skema pensionale për grupet e veçanta .....	26
2.1.6	Çështje në lidhje me sistemin aktual pensional .....	27
2.2	Ndihma sociale dhe sistemet e mirëqenies sociale .....	28
2.2.1	Pasqyrë .....	28
2.2.2	Ndihma sociale .....	29
2.2.3	Shërbimet sociale dhe familjare .....	31
2.2.4	Beneficionet për invalidët e luftës .....	32
2.3	Sistemi i kujdesit shëndetësor.....	32
2.3.1	Sistemi publik i kujdesit shëndetësor në Kosovë .....	32
2.3.2	Shpenzimet shëndetësore .....	33
2.3.3	Debati për krijimin e sigurimit shëndetësor .....	34
2.4	Beneficionet e tjera të sigurimit social .....	35
<b>3</b>	<b>Konkluzionet përmbyllëse .....</b>	<b>37</b>
<b>Shtojca A</b>		
A.1	Sistemi i sigurimit social në Shqipëri .....	38
A.2	Sistemi i sigurimit shëndetësor në Shqipëri .....	39
<b>Shtojca B</b>		
B.1	Referencat .....	40
B.2	Legjislacioni përkatës në Kosovës .....	41
B.3	Konventat përkatëse të ONP-së .....	42
B.4	Personat e intervistuar .....	42

---

## Tabelat dhe Ilustrimet

- Tabela 1. Treguesit kyç makroekonomik, 2004–08  
Tabela 2. Trendët e rritjes së popullsisë, 1971–2007  
Tabela 3. Rritja e popullsisë, 2005–08  
Tabela 4. Treguesit e tregut të punës, 2008  
Tabela 5. Treguesit e varfërisë, 2001 dhe 2003  
Tabela 6. Pjesëmarrja në arsimin publik, 2007–08  
Tabela 7. Beneficionet pensionale dhe të ardhurat për kokë banori, 2004–08  
Tabela 8. Numri i pensionistëve dhe shpenzimet pensionale (pensioni bazë i të moshuarve), 2005–08  
Tabela 9. Shpenzimet pensionale (pensioni bazë invalidor), 2004–08  
Tabela 10. Shpenzimet e përgjithshme pensionale, 2004–08  
Tabela 11. Numri i punëdhënësve dhe të punësuarve në FKPK, 2002–08  
Tabela 12. Rritja e aseteve të FKPK-së, 2002–09  
Tabela 13. Ndihma sociale: numri i përfituesve dhe shpenzimet, 2006–08  
Tabela 14. Përfituesit e skemës së invalidëve të luftës, 2008  
Tabela 15. Shpenzimet për skemën e invalidëve të luftës, 2007–08  
Tabela 16. Shpenzimet shëndetësore, 2006  
Tabela 17. Pagesat për shërbimet mjekësore  
Tabela 18. Kontributet e vlerësuara për sigurimin shëndetësor bazuar në të dhënat e vitit 2005)
- Ilustrimi 1. Sektorët ekonomik sipas proporcionit të BPV-së (%)  
Ilustrimi 2. Ndarja sektoriale e ndërmarrjeve kosovare, 2008 (%)  
Ilustrimi 3. Piramida e popullsisë, 1999  
Ilustrimi 4. Papunësia sipas grupit të moshës, 2008  
Ilustrimi 5. Papunësia sipas nivelit të aftësive profesionale, 2008  
Ilustrimi 6. Papunësia sipas rajonit, 2008  
Ilustrimi 7. Papunësia sipas sektorëve, 2007  
Ilustrimi 8. Nivelet e varfërisë në Kosovë  
Ilustrimi 9. Punët kryesore të kryera nga fëmijët  
Ilustrimi 10. Sëmundjet më të shpeshta në Kosovë, 2006  
Ilustrimi 11. Luhatja e vlerës së aksioneve të FKPK-së, 2002–09

---

## Akronimet

AAP	Arsimimi dhe Aftësimi Profesional
ABEF	Anketa e Buxhetit të ekonomive familjare
AIP	Agjencia e Inspektimit të Punës
AMSJ	Anketa për Matjen e Standardeve të Jetesës
BB	Banka Botërore
BPV	Bruto Produkti Vendor
BSPK	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
DPA	Departamenti i Administratës Pensionale
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EAR	Agjencia Evropiane për Rindërtim
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnimeve
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSSH	Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Shqipërisë
ISKSH	Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor të Shqipërisë
ISSH	Instituti i Sigurimit Social të Shqipërisë
KB	Kombet e Bashkuara
KDIA	Klasifikimi Ndërkombëtar i Standardizuar i Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PNEPF	Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve
QKSH	Qendrat e Kujdesit Shëndetësor
QMF	Qendrat e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendrat për Punë Sociale
RZhNj	Raporti i Zhvillimit Njerëzor
SPT	Sistemi i Pensionit të Transferuar
TMK	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
UE	Unioni Evropian
UNFPA	Fondi i Popullsisë të Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara
ZPP	Zyra për Punësim Publik

---

## Hyrje

Ky raport paraqet vlerësimin fillestar të sistemit aktual të sigurimit social në Kosovë<sup>1</sup>. Për të kryer këtë studim, Zyra nën-rajonale e ONP-së për Evropën Qendrore dhe Lindore ka kontraktuar dy ekspertë shqiptarë:

Z. Qemal Balliu, Drejtor ekzekutiv i fondacionit për zhvillimin e biznesit, dhe  
Z. Ali Emini, Drejtor i përgjithshëm i institutit për sigurim social.

Sipas kushteve të punës, studimi përfshin komponentët kryesor si më poshtë:

- 1) kontekstin e përgjithshëm të situatës makroekonomike në Kosovë, duke përfshirë në veçanti trendët demografik dhe situatën ekonomike dhe sociale të popullsisë;
- 2) një pasqyrë të përgjithshme të sistemit aktual të sigurimit social, që përfshin (a) sigurimin social dhe pensionet, (b) sigurimin shëndetësor dhe strategjitë e ardhshme dhe (c) sistemet tjera të mbrojtjes sociale; dhe
- 3) një analizë të çështjeve relevante dhe rekomandimeve për përmirësimet e mundshme nëpërmjet konsultimeve me palët përkatëse të interesuara.

Pas shqyrtimit të literaturës ekzistuese për sigurimin social në Kosovë, të dy ekspertët kanë vazhduar misionin e tyre në Prishtinë nga 18 deri më 22 maj 2009 për të mbledhur drejtpërdrejt të dhënat dhe informatat nga organizatat përkatëse dhe për t'u konsultuar me palët kryesore të interesuara. Ata kanë pasur takime në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Entin e Statistikave të Kosovës, BSPK-në dhe Odën Ekonomike të Kosovës. Pas përpilimit të raportit fillestar, të dy ekspertët kanë vazhduar me misionin përcjellës në Prishtinë nga 21 deri më 23 korrik 2009 në mënyrë që të paraqesin draftin fillestar të raportit tek palët kryesore të përfshira dhe për të kërkuar komentet, korrigjimet dhe sugjerimet e tyre, të cilat do të mund të përmirësonin raportin.

Drafti i raportit është korrigjuar duke përfshirë komentet teknike nga Z. Kenichi Hirose, Ekspert i lartë për sigurim social në zyrën nën-rajonale të ONP për Evropën Qendrore dhe Lindore.

Ky raport është organizuar si në vijim. Kapitull 1 paraqet kornizën e përgjithshme demografike dhe ekonomike për analizimin e sistemit të sigurimit social në Kosovë. Kapitulli 2 ofron informata të azhurnuara për karakteristikat e theksuara të nën-sistemeve kryesore të sigurimeve sociale në Kosovë. Kapitulli 3 përfundon me vërejtjet e përgjithshme mbi zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të sigurimit social në Kosovë.

Autorët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë ata të cilët kanë kontribuar në këtë studim. Falënderim i veçantë i bëhet Zyrës së ONP-së/ PNEPF-it në Prishtinë dhe Koordinatorit Kombëtar të ONP-së në Shqipëri, për mbështetjen e tyre administrative gjatë misionit të dy ekspertëve shqiptarë.

---

<sup>1</sup>Në tërë raportin, referencat Kosovës duhet të nënkuptohen sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB-së[1999].

# 1 Konteksti demografik, ekonomik dhe social

## 1.1 Pasqyrë

Kosova ka hapësirë tokësore prej 10.887 km<sup>2</sup> dhe më shumë se dy milion banorë. Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina, me një popullsië prej më shumë se gjysmë milioni banorë. Në aspektin administrativ Kosova ndahet në shtatë rajone dhe 36 komuna.

Statusi aktual i Kosovës është përcaktuar sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të (KS i OKB-së) Bashkuara, të miratuar më 10 qershor 1999, e cila vendos Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Më 17 shkurt 2008, Kosova ka shpallur pavarësinë. Megjithatë, më 8 tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka vendosur të kërkoj mendimin këshillëdhënës jodetyrues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë nga Serbia. *Në tërë raportin, referencat ndaj Kosovës duhet të nënkuptohen sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB-së [1999].*

## 1.2 Situata makroekonomike


Në vitet e fundit, Kosova ka shënuar përparim të madh në tranzicionin e saj drejt një ekonomie tregu. Disa organizata, si OKB-ja, BE-ja dhe USAID-i, kanë ndihmuar në zhvillimin e Kosovës nëpërmjet programeve dhe projekteve të ndryshme. Siç shihet më poshtë në Tabelën 1, në vitet e kaluara rritja e BPV-së ka qenë progresive, duke arritur në 5 për qind në vitin 2008. Sidoqoftë, Kosova vazhdon të pranoj shuma të konsiderueshme të fondeve nga burimet e jashtme. Remitancat e emigrantëve kanë arritur në 16,6 përqind të BPV-së në fund të vitit 2008, kurse ndihma financiare nga bashkësia ndërkombëtare ka arritur në 15 përqind.

**Tabela 1. Treguesit kyç makroekonomik, 2004–08**

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
BPV (€ milion)	2,348	2,384	2,341	2,474	2,684
Rritja e BPV (%)	3.2%	-1%	2.6%	2.8%	5%
BPV për kokë banori (€)	1,195	1,143	1,152	1,197	1,277
Inflacioni (%)	-1.4	-1.4	1.5	4.2	4.0
Remitancat (% të BPV)	9.3	12.0	15.0	16.0	16.6

Siç shihet në Ilustrimin 1, pjesa më e madhe e BPV-së në vitin 2007, në lartësi prej 60 përqind është mbuluar nga shërbimet dhe tregtia, ndërsa bujqësia dhe industria kanë mbuluar nga rreth 20 përqind të BPV-së.

**Ilustrimi 1. Sektorët ekonomik sipas proporcionit të BPV(%)**




Përkundër ndihmës së konsiderueshme financiare dhe teknike nga bashkësia ndërkombëtare, të ardhurat e kosovarëve kanë mbetur të vogla; të ardhurat mesatare për kokë banori në vitin 2008 kanë qenë 1,277 euro. Niveli i lartë i papunësisë – rreth 40 përqind – ka rezultuar në rritjen e emigracionit dhe punës në ekonominë informale. Numri i përgjithshëm i të papunësuarve në korrik 2008 ka qenë 335,920, që do të thotë rritje prej 1 përqind që nga korriku 2007. Për shkak të përmasave të mëdha të ekonomisë informale, shifra e papunësisë së regjistruar mund të mos pasqyroj plotësisht situatën e punësimit në sektorin privat.

Sektori financiar në Kosovë mbetet në gjendje të mirë, përkundër krizës globale financiare. Aktualisht në Kosovë funksionojnë shtatë banka komerciale, nëntë kompani sigurimi dhe dy fonde pensionale. Përdorimi i euros si valutë zyrtare kontribuon në stabilitetin e ekonomisë së Kosovës dhe mban inflacionin në normë të pranueshme, duke siguruar kështu një bazë të shëndoshë për politikën monetare. Një prej dobive nga përdorimi i euros është eliminimi i kostos së transaksioneve në lidhje me shkëmbimet tregtare dhe pagesat në Evropë. Para vitit 2008, Kosovës nuk i është lejuar marrja e mbështetjes financiare për shkak se nuk ka qenë anëtare e ndonjë institucioni financiar ndërkombëtar. Pas anëtarësimit të Kosovës në FMN dhe BB më 2009, ajo mund të merr hua dhe asistencë teknike nga këto institucione, si dhe nga institucionet evropiane dhe institucionet tjera ndërkombëtare financiare.

Më 2006, nën patronazhin e UNMIK-ut, Kosova është anëtarësuar në Marrëveshjen për tregti të lirë në Evropën qendrore dhe lindore (CEFTA). CEFTA dhe shtetet anëtare të BE-së vazhdojnë të jenë dy partnerët kryesor tregtar të Kosovës, ku secila prej tyre arrin deri në 37 përqind të tregtisë së përgjithshme në pjesën e parë të vitit 2008 (Raporti i BE-së, 2008). Produktet kryesore të eksportuara të Kosovës janë metalet dhe produktet metalike (gati 50 përqind të eksportit të përgjithshëm më 2007). Produktet minerare, kryesisht nafta, janë produktet më të importuara në Kosovës, duke arritur në 20 përqind të importit të përgjithshëm më 2008.

Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në Kosovë është rritur viteve të fundit, duke treguar për një rritje të qëndrueshme nga 8 deri në 12 përqind në vit. Deri më 2009, numri i NVM-ve ka arritur numrin 67,950, 46 përqind e të cilave në sektorin e tregtisë, 13 përqind në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit dhe 10 përqind në sektorin e industrisë (shih Ilustrimin 2).

**Ilustrimi 2. Ndarja sektoriale e ndërmarrjeve kosovare, 2008 (%)**



### 1.3 Trendët demografik

Sipas Entit të Statistikave të Kosovës (ESK), popullsia e Kosovës në fund të vitit 2007 ka qenë 2,13 milion banorë ndërsa përbërja etnike ishte 92 përqind shqiptarë dhe 8 përqind komunitete tjera.

**Tabela 2. Trendët në rritjen e popullsisë, 1971–2007**

Viti	Popullsia	Norma e rritjes
1971	1,243,093	-
1981	1,584,440	27%
1991	1,956,196	23%
2007	2,126,708	9%

Burimi: ESK 2008

Në vitet 1980 dhe 1990, Kosova ka shënuar norma të larta të rritjes së popullsisë si rezultat i normës së lartë të natalitetit dhe normës së ulët të mortalitetit. Ky trend ka ndryshuar gradualisht, duke rezultuar në ngadalësimin e normës së rritjes së popullsisë. Norma e përgjithshme e natalitetit është përafërsisht tri fëmijë për një grua dhe jetëgjatësia është 69 vite. Rritja e natyrshme e popullsisë në vitet e fundit ka qenë rreth 34.000 deri 35.000 persona, siç edhe shihet në Tabelën 3. Norma e rritjes së popullsisë është 1,46 përqind sipas vlerësimeve të UNFPA-së (2003).


**Tabela 3. Rritja e popullsisë, 2005–08**

Viti	2005	2006	2007	2008
Popullsia ('000)	1,999	2,032	2,067	2,102
Rritja reale ('000)	34	34	34	
Norma e rritjes %	1.73%	1.73%	1.73%	1.78%

Burimi: FMN 2008

Popullsia e Kosovës është e re dhe me një mesatare prej 23 vjet. Përafërsisht një e treta e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare përdorisht vetëm 6 përqind janë mbi moshën 65 vjeçare. Mosha e popullsisë të aftë për punë është ndërmjet 15 dhe 64 vjeç, që përbën 61 përqind të popullsisë së përgjithshme. Ilustrimi 3 tregon strukturën e gjinisë dhe moshës së popullsisë, duke u bazuar në një hulumtim të UNFPA-së më 1999. Vërehet se piramida e popullsisë ka një bazë të gjerë, që pasqyron numrin e madh të fëmijëve, por gjithashtu vërehet mungesa e meshkujve të moshës 20-50 vjeç për shkak të emigrimit

**Ilustrimi 3. Piramida e popullsisë, 1999**



Burimi: UNFPA 1999

## 1.4 Tregu i punës

Duhet të theksohet se të dhënat për tregun e punës duhet të trajtohen me kujdes për shkak të disponueshmërisë dhe kualitetit të kufizuar të tyre. Mungesa e të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitet e fundit vetëm se vështirëson vlerësimin e situatës në tregun e punës dhe trendët e ardhshëm. Bazuar në Raportin vjetor për vitin 2008, Departamenti i Punës dhe Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale vlerëson se numri i përgjithshëm i të papunëve të regjistruar në Zyrën për Punësim Publik (ZPP) ka qenë 334,595 persona në fund të vitit 2008, që do thotë një rritje prej 0,4 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Tregu i punës së Kosovës vështirë se mund të absorboj 35.000 punëkërkuesit e rinj, të cilët futen në këtë treg për çdo vit. Niveli i lartë i papunësisë në Kosovë i atribuohet disa arsyeve, duke përfshirë bazën e dobët fillestare të prodhimit, reformat strukturore të lidhura me privatizimin, nivelin e ulët të investimeve vendore dhe të huaja, mungesën e politikave aktive dhe efikase të punësimit dhe nivelin e ulët të kualifikimit të punëkërkuesve (Raporti i BE-së 2008).

Norma e papunësisë më 2008 ka qenë 41 përqind (58 përqind për femrat dhe 33 përqind për meshkujt) bazuar në të dhënat e përgatitura nga FMN-ja, ESK-ja dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Norma e lartë e papunësisë është më e pranishme tek të rinjtë, të moshës 15-24 vjeç, siç shihet në Tabelën 4.


**Tabela 4. Treguesit e tregut të punës, 2008**

Treguesit	Totali	Meshkuj	Femra	Mosha 15–24
Përbërja e popullsisë	100%	51%	49%	19%
Numri i banorëve	2,153,000	1,098,000	1,055,000	411,000
Popullsia e aftë për punë (në % së gjithë popullsisë të të gjitha moshave)	64%	62%	65%	
Popullsia e moshës për punë	1,371,000	686,000	685,000	411,000
Të papunësuar	335,900	177,800	158,100	101,700
Të punësuar	481,000	365,800	115,200	72,300
Popullsia aktive	816,900	543,600	273,300	174,000
Norma e pjesëmarrjes	60%	79%	40%	42%
Norma e papunësisë	41%	33%	58%	58%
Norma e punësimit	35%	53%	17%	18%

Burimi: ESK 2008


Ilustrimi 4 tregon papunësinë sipas grupeve të moshës më 2008, të vlerësuar nga ESK-ja. Përqindja më e madhe e të papunësuarve është në grupin e moshës 25-39 vjeç, me 44 përqind, ndjekur nga grup moshë 15-24 vjeç, me 30 përqind.

**Ilustrimi 4. Papunësia sipas grupit të moshës, 2008**




Siç tregohet në Ilustrimin 5, 60 përqind e të papunësuarve janë punëtorët e pakualifikuar, të cilët kanë kryer vetëm arsimin parashkollor, fillor apo të mesëm të ulët, përdherisa 26 përqind kanë përfunduar shkollën e mesme<sup>2</sup>

**Ilustrimi 5. Papunësia sipas nivelit të aftësive profesionale, 2008**



Ilustrimi 6 paraqet normën e papunësisë sipas rajonit. Rajonet e Prishtinës dhe Mitrovicës kanë normën më të lartë të papunësisë, rreth 19 përqind.


**Ilustrimi 6. Papunësia sipas rajonit, 2008**



Siç tregohet në Ilustrimin 7, përbërja sektoriale e të punësuarve është si në vijim: bujqësi-14.6 përqind, prodhimtari-10.4 përqind, tregti-16.9 përqind, administratë publike-9.6 përqind, arsim-12.1 përqind dhe sektorin e shëndetësisë-7 përqind.

<sup>2</sup>Sipas Klasifikimit ndërkombëtar të standardizuar të arsimit (ISCED), personat e pakualifikuar janë ata në grupet 0-2, d.m.th personat me arsim parashkollor, fillor apo të mesëm të ulët, ndërsa ata në grupin 3 të ISCED-it janë ata persona me arsim të mesëm.

**Ilustrimi 7. Punësimi sipas sektorit, 2007**



## 1.5 Ekonomia informale

Në Kosovë, përmasat në rritje të ekonomisë informale janë një shqetësim i madh. Duhet t'i jepet prioritet i lartë krijimit dhe zbatimit të strategjive efikase për zhvendosjen aktivitetëve informale në sektorin formal.

Deri më sot, nuk është kryer ndonjë analizë gjithëpërfshirëse për ekonominë informale në Kosovë. Një vlerësim i fundit i kryer nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) më 2007, i cili ka përdorë përkufizimet e OECD-së dhe modelin e buxhetit makroekonomik të ekonomive familjare, vlerëson se madhësia e ekonomisë informale në Kosovë është prej 27 deri në 35 përqind të BPV për 2004-06. Gati 85 përqind e kësaj i atribuohet punëtorëve të cilët nuk paguajnë kontributet e sigurimit social apo taksën për të ardhurat personale.

Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore më 2003, më shumë se gjysma e personave të punësuar në Kosovë punojnë pa një kontratë pune ose punojnë në ndërmarrjet e paregjistruara. Problemi i ekonomisë informale është theksuar edhe në një anketë të ONP-së, sipas së cilës 50 përqind e të rinjve punojnë në ekonominë informale, 73 përqind e të cilëve nuk paguajnë kontributet e sigurimit social.

Institucioni që ka për mandat luftimin e punësimit informal është Agjencia e Inspektimit të Punës (AIP), e cila është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (2001/27). Detyrat dhe përgjegjësitë e AIP-së janë përcaktuar sipas Ligjit mbi Inspektoratin e Punës në Kosovë (2002/09), i cili është ndryshuar dhe plotësuar më 2008 në bazë të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Inspektoratit të Punës (2008/03/L-017). Në bazë të ligjit aktual, AIP-ja mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë të punësuarve në vendet e punës. Në vitin 2009, AIP-ja ka pasur një inspektor të përgjithshëm, tre zëvendës inspektorë të përgjithshëm dhe 51 inspektorë të punës (numri i inspektorëve të punës do të rritet në 55 më 2010) Raporti i AIP-së për çerekun e parë të vitit 2009 arrin në përfundim se, gjatë 1,801 inspektimeve të kryera, janë identifikuar 40 ndërmarrje të palicencuara të cilat kanë shmangur të gjitha obligimet e tyre dhe 72 ndërmarrje të cilat kanë punësuar 274 punëtorë pa kontratë pune. AIP-ja vlerëson se 30 përqind e punëtorëve nuk kanë poseduar kontratë pune më 2008. AIP-ja ka mungesë të burimeve njerëzore dhe financiare derisa kualifikimet profesionale të punonjësve të saj janë nën nivelin e dëshiruar. Për të zvogëluar punësimin informal, AIP-ja bashkëpunon me institucionet tjera, si administratën e taksave, policinë, sindikatat dhe asociacionet e punëdhënësve.

## 1.6 Varfëria

Sipas Indeksit të zhvillimit njerëzor, Kosova është në vendin e fundit në Evropën juglindore dhe

është ndër shoqëritë më së paku të zhvilluara në Evropë. Papunësia është identifikuar si një ndër shkaktarët kryesor të varfërisë në Kosovë. Rrethanat politike në dekadat e fundit kanë kontribuar në mungesën e investimeve, zgjerimin e ngadalshëm të bizneseve dhe numrin e ulët të krijimit të bizneseve të reja dhe po ashtu nivelin e ulët të arsimit të përgjithshëm dhe profesional. Më 2004, UNDP ka kryer një studim për matjen e varfërisë në Kosovë duke përdorur dy lloje të Treguesve të varfërisë njerëzore (TVNj). Treguesi i parë, HPI-1, është projektuar për të matur shpeshtinë e varfërisë ekstreme kurse treguesi i dytë HPI-2 matë varfërinë jo ekstreme. Sipas Raportit të zhvillimit njerëzor 2004, niveli i varfërisë ekstreme në Kosovë ka rënë nga 17.6 përqind më 2001 në 9.7 më 2003, kurse përqindja e popullsisë të paafte për të përmbushur nevojat e tyre të përditshme është rritur nga 11.9 në 13 përqind, siç tregohet në Tabelën 5. Edhe pse treguesit tjerë, si niveli i papunësisë dhe përqindja e njerëzve të cilët jetojnë me 2 dollarë amerikanë në ditë, tregojnë për një rënie në varfëri, ata ende janë në një nivel të lartë.

**Tabela 5. Treguesit e Varfërisë, 2001 dhe 2003**


	2001	2003
<b>HPI-1 (zbatohet për vendet në zhvillim)</b>	17.6%	9.7%
Popullsia që nuk mbush moshën 40 vjeçare	25.30%	7%
Të rriturit analfabet	6.50%	5.80%
Njerëzit pa ujë të pijshëm	4.40%	27.40%
Njerëzit pa shërbime mjekësore		8.90%
Mortaliteti i fëmijëve	3.50%	3.50%
Fëmijët e lindur nën peshë	4.10%	4.00%
Njerëzit pa standard të mirë jetese	11.90%	13%
<b>HPI-2 (zbatohet për vendet e zhvilluara)</b>		36.70%
Popullsia që nuk mbush moshën 60 vjeçare		13.40%
Personat analfabet	6.50%	5.80%
Njerëzit që jetojnë me 2 Dollar Amerikan	50.30%	47.70%
Papunësia sipas grup moshës 15-64	50-55%	44.40%

Burimi: UNDP 2007

Një hulumtim i hollësishëm i varfërisë në Kosovë është kryer më 2001 nga Anketa për matjen e standardeve të jetesës (AMSJ) e Bankës Botërore në bashkëpunim me ESK-në dhe ka përfshirë 2880 familje. Hulumtimi vlerëson se kufiri i varfërisë ka qenë €53.67 për muaj. Një vlerësim i dytë i varfërisë është kryer më 2005 nga Anketa e buxhetit të ekonomive familjare (ABEF) dhe ka përfshirë 2400 familje. Në këtë rast kufiri i varfërisë është vlerësuar të jetë vetëm €42.30 për muaj. Vlerësimi më i fundit është kryer më 2007 (për ABEP-in me 2400 familje) por kufiri i varfërisë nuk ka ndryshuar krahasuar me hulumtimin e mëhershëm më 2005.

Duke krahasuar ABEP-in të kryer më 2005 dhe atë më 2007, rezulton se shpeshtësia e varfërisë është rritur prej 43.5 në 45.1 përqind dhe ajo e varfërisë ekstreme nga 13.6 në 16.7 përqind (shih Ilustrimin 8). Faktorët të cilët kanë ndikuar në uljen e varfërisë janë emigracioni dhe remitancat, duke përfshirë pensionet nga jashtë.

**Ilustrimi 8. Niveli i varfërisë në Kosovë**



Sa i përket strukturës së hollësishme të varfërisë, vërejtjet e mëposhtme janë:

- Shpeshtësia e varfërisë tek familjet me më shumë se shtatë anëtarë është 7 përqind më e lartë se tek familjet me më pak se katër anëtarë.
- Shpeshtësia e varfërisë tek familjet me gratë kryefamiljare është 4 përqind më e lartë se tek familjet me burrat kryefamiljar.
- Shpeshtësia e varfërisë tek personat e papunësuar është 50 përqind më e lartë se sa tek personat e punësuar. Ndërmjet 32 deri 35 përqind e personave të punësuar janë të varfër, shumica e të cilëve janë punëtorë të zakonshëm dhe minatorë.
- Varfëria në rajonet rurale është 5 deri në 10 përqind më e lartë se në rajonet urbane. Rajonet e Mitrovicës dhe Ferizajt kanë shpeshtësinë më të lartë të varfërisë në Kosovë.
- Për më shumë, gati 8 përqind e popullsisë përjetojnë varfërinë shumëdimensionale: ata janë materialisht të varfër, pa ujë të pijshëm në shtëpitë e tyre apo qasje në shërbimet sanitare apo shëndetësore.

Kushtet ekonomike në Kosovë e bëjnë të vështirë sigurimin e burimeve të mjaftueshme për financimin e mbrojtjes sociale, posaçërisht për grupet e rrezikuara. Sa i përket kursimeve në skemat të sigurimit social, Anketa e Bankës Botërore më 2007 thekson se, për shkak të mbulimit të ulët dhe nivelit të ulët të përfitimeve, skema ka dështuar të ketë një ndikim thelbësor në përmirësimin e mirëqenies.

Në Kosovë rreth 6.9 përqind e popullsisë marrin asistencë sociale. Grupet e veçanta të rrezikuara përfshijnë: (i) familjet e mëdha me gjashtë apo më shumë anëtarë, (ii) familjet me të varur nga ato, (iii) familjet me gratë kryefamiljare, (iv) të papunësuarit dhe deri në një shkallë të vetë-punësuarit.

Një faktor tjetër që kontribuon në uljen e varfërisë është numri i madh i punëtorëve emigrantë dhe remitancat e tyre. Vlerësohet se 20 përqind e familjeve kosovare kanë një anëtar të familjes jashtë vendit. Shpeshtësia e varfërisë në këto familje me së paku një anëtar jashtë vendit është 7 përqind më e vogël se mesatarja.

## 1.7 Sistemi i arsimit

Përpjekjet për të krijuar një sistem efikas të arsimit janë penguar seriozisht nga infrastruktura e dobët arsimore, hapësirat joadekuate, programet mësimore të mangëta dhe mungesa e kualifikimeve të mësimdhënësve dhe burimet të mjaftueshme financiare.

UNMIK-u ka filluar reformimin e sistemit arsimor më 1999. Më 2002, përgjegjësia për zhvillimin e sistemit arsimor është bartur nga UNMIK në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Një numër i donatorëve ndërkombëtare kanë kontribuar në ristrukturimin e sistemit arsimor.

BE-ja është një ndër partnerët më aktiv të MASHT-it në promovimin e arsimit të kualitetit të lartë në Kosovë. Bazuar në planin e zhvillimit për vitin 2009, BE-ja – nëpërmjet agjencisë së saj ekzekutive, Fondacionin Evropian për Trajnim (ETF) – do të përqendroj ndihmën e saj në zhvillimin e kornizës strategjike për arsimimin gjatë tërë jetës, duke mbuluar të gjitha format (zyrtare dhe jozyrtare) dhe të gjitha nivelet (parashkollor, fillor, të mesëm, universitet dhe për të rriturit, në baza të vazhdueshme) e arsimimit dhe trajnimeve.

Sipas të dhënave të ESK-së, në vitin akademik 2007-08 përafërsisht gjysmë milioni studentë kanë ndjekur të gjitha nivelet e shkollave publike në Kosovë. Derisa dallimi ndërmjet meshkujve dhe femrave është i vogël sa i përket vijimit të shkollave parashkollore dhe fillore është i vogël, ky dallim zgjerohet në lidhje me arsimin e mesëm dhe të lartë, që nënkupton se më pak femra përfundojnë arsimimin e lartë (shih Tabelën 6).

**Tabela 6. Pjesëmarrja në arsim publik, 2007-08**

Niveli	Arsimi	Totali	Femra	Meshkuj	Dallimi femra-meshkuj (%)
0	Arsimimi parashkollor	24,315	11,756	12,559	7%
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët	324,398	155,640	168,758	8%
1+2s	Fillor dhe i mesëm i ulët special	722	276	446	62%
3	Arsimimi i mesëm i lartë	90,625	40,279	50,346	25%
3s	Arsimimi i mesëm special	167	55	112	104%
5	Arsimimi terciar	25,840	12,610	13,230	5%
	Totali	466,067	220,616	245,451	11%

Burimi: ESK 2008

Raporti mësimdhënës – student në Kosovë për 2007-08 është pak më pak se 1:20, që është afër standardeve ndërkombëtare. Disa shkolla private janë themeluar vitet e fundit, të cilat kanë regjistruar 2606 studentë (niveli parashkollor, fillor dhe ai i mesëm) më 2007-08, që është 0.6 përqind e numrit të përgjithshëm. Nuk ekzistojnë të dhëna në statistikat e ESK-së sa i përket numrit të studentëve të cilët vijnë në universitetet dhe kolegjet private.

Në sistemin e ri arsimor, arsimimi parashkollor përfshin institucionet për kujdesin fëmijëve – çerdhe për foshnje të moshës 9 muaj deri 3 vjet, çerdhe për fëmijët nga 3 deri në 6 vjet, dhe klasat parashkollore në shkollat fillore për fëmijët 5-6 vjeçar. Sipas UNICEF-it, vetëm 10 përqind e fëmijëve vijnë në arsimin parashkollor. Sipas të dhënave të fundit të MASHT-it, janë 40 çerdhe kryesisht në rajonet urbane. Vlerësohet se 42 përqind e fëmijëve të regjistruar në shkollat e mesme nuk kanë pasur çfarëdo arsimimi parashkollor.

Bazuar në të dhënat e UNDP, vijimi në shkollat fillore në Kosovë është rreth 95 përqind ndërsa vijimi në shkollat e mesme është 75 përqind. Një në dy të rinj braktisin shkollën në moshën 18 vjeçare. Dy nga tre studentë braktisin shkollën pa asnjë kualifikim. Vlerësohet se 12 përqind e studentëve braktisin arsimimin obligativ dhe 28 përqind nuk e përfundojnë shkollën e mesme.

Aktualisht në Kosovë janë 969 shkolla fillore, 108 shkolla të mesme dhe 6 shkolla speciale. Së bashku, këto përmbushin rreth 60 përqind të kërkesave për hapësira shkollore. Një problem është mungesa e ndërtesave shkollore. Shumica e shkollave punojnë në dy apo tri ndërrime. Shpesh,

---

shkollat në rajonet rurale gjinden shumë larg vendbanimit të nxënësve, duke ua vështirësuar atyre vijimin e mësimi.

MASHT-i ka krijuar një strategji për arsimimin parauniversitar 2007-17, duke definuar caqet kryesore në vijim:

- sigurimin e kualitetit, qeverisjes dhe menaxhimit efikas të sistemit arsimor;
- ndërtimin e sistemit funksional për të siguruar mësimdhënie të kualitetit të lartë, bazuar në standardet e vendeve të zhvilluara;
- synimin për përfshirjen e të gjithëve, barazia dhe respektit i shumëllojshmërisë në arsim;
- themelimin e një sistemi trajnimit efikas për mësimdhënësit;
- garantimin e një ambienti të shëndoshë për arsim;
- themelimin e një marrëdhënie të qëndrueshme ndërmjet arsimit dhe zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social;
- përmirësimi i burimeve në sistemin arsimor.

Aktualisht ekzistojnë dy universitete publike në Kosovë, njëri në Prishtinë dhe tjetri në Mitrovicë. Sistemi i zbatuar në Universitetin e Prishtinës është i bazuar në procesin e Bolonjës, i cili lehtëson lëvizshmërinë e studentëve dhe transferimin e kredive ndërmjet universitetet. MASHT-i ka ndër-marrë masat e nevojshme për të përmirësuar përmbajtjen e lëndëve të ligjëruara, kualifikimin e fakulteteve dhe mbikëqyrjen e kualitetit dhe menaxhimit. Më 2008, MASHT-i ka kërkuar nga Këshilli Britanik i Akreditimit për të vlerësuar 33 institucionet private të arsimit të latë në bazë të legjislacionit kombëtar, standardeve ndërkombëtare dhe procesit të Bolonjës. Sipas raportit përfundimtar, 32 nga 33 institucione janë klasifikuar që nuk kanë përmbushur standardet dhe zyrtarisht janë suspenduar nga MASHT-i. Agjencisë së Akreditimit të Kosovës i është kërkuar të ofroj akreditimin e saj pasi që këto institucione të kenë përmbushur kërkesat themelore të arsimit.

Dy ligje kryesore janë miratuar më 2008. I pari është Ligji mbi kornizën e kualifikimeve kombëtare (2008/03-L-06), i cili i mundëson Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve institucionalizimin e kualifikimeve dhe procedurave të certifikimit. I dyti është Ligji mbi Arsimin në komuna (2008/03-L068), i cili synon të rregulloj organizimin e institucioneve arsimore publike në nivel komunal dhe të definoj kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve qendrore dhe komunale sa i përket arsimimit (Raporti i BE-së 2008).

Në lidhje me arsimimin dhe aftësimin profesional, më 2006 Ligji mbi arsimin dhe aftësimin profesional (2006/02-L42) është miratuar dhe i cili synon të rregulloj sistemin e AAP-së sipas standardeve evropiane. Në përgjithësi, janë 56 shkolla ofrojnë AAP në Kosovë. Megjithatë mungesa e akreditimit në këto shkolla minon besueshmërinë e certifikimit në sistemin e AAP-së. Për më tepër, nuk ka bashkëpunim efikas ndërmjet MASHT-it dhe MPMS-së.

Ndërmjet viteve 2001 dhe 2007, ONP-ja ka zhvilluar projektin me titullin “Zhvillimi i kapaciteteve për ringjallje dhe rindërtim në Kosovë”, i cili ishte dizajnuar për të ringjallur kapacitetet e punësimit dhe ofrimit të asistencës Kosovës në rrugën drejt një ekonomie tregu. Projekti ka arritur rezultatet e mëposhtme:

- fuqizimin e institucioneve të tregut të punës, si Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyrrat Publike të Punësimit dhe institucionet rajonale të trajnimit;
- krijimin e sistemit të AAP-së për të papunët;
- ndërtimin e kapaciteteve për institucionet e tregut të punës në lidhje me ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë konsultimet, orientimet dhe identifikimin e vendeve të lira të punës për punëkërkuarit;

- zhvillimin e një sistemi i cili promovon vetëpunësimin nëpërmjet sistemit të AAP-së dhe shërbimeve të punësimit;
- fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve të tregut të punës dhe partnerëve social në lidhje me përgatitjen, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e politikave dhe programeve të punësimit për të rinjtë.

Programi ka siguruar trajnime për të rinjtë në lidhje me aftësitë dhe vetëpunësimin; ka ndihmuar punëkërkuuesit për të vlerësuar aftësitë e tyre të punës; dhe ka ofruar asistencë në themelimin e bizneseve. Programet e trajnimit dhe aftësimin janë zhvilluar për personelin e ZPP-ve për tu mundësuar atyre identifikimin e të rinjve në rrezik dhe për përdorimin e aftësive të duhura të këshillimit dhe udhëzimit. Është zhvilluar një fushatë mediale dhe është instaluar një linjë telefonike falas për të informuar të rinjtë për të drejtat e tyre në punë. Si rezultat, nga mesi i vitit 2007, përafërsisht 140.000 njerëz kanë përfutuar nga shërbimet e punësimit dhe trajnimit të ofruara nga projekti i ONP-së.

## 1.8 Puna e fëmijëve

Edhe pse Kosova ka bërë përpjekje për të krijuar një kornizë ligjore dhe institucionale për të parandaluar punën e fëmijëve, në Kosovë ekziston një traditë që fëmijët punojnë për të ndihmuar familjet e tyre. Zakonisht kjo përfshin punët rreth shtëpisë dhe ndihmën në aktivitetet bujqësore. Rishtazi, është shënuar një rritje e konsiderueshme në numrin e fëmijëve të cilët punojnë në rrugë. Janë duke u ndërmarr përpjekje për të parandaluar dhe eliminuar punën e fëmijëve, me ndihmën nga organizatat ndërkombëtare si ONP-ja dhe UNICEF-i.

Që nga viti 2004, ONP-ja zbaton në Kosovë një program të bashkëpunimit teknik kundër punës së fëmijëve dhe eksploatimit dhe trafikimit të fëmijëve nëpërmjet Programit ndërkombëtar për eliminimin e punës së fëmijëve (PNEPF). Synimi i PNEPF-së është të ndihmoj në krijimin e një ambienti të favorshëm në të cilin format më të këqija të punës së fëmijëve (FKPF) mund të parandalohen, duke përfshirë:

- përfshirjen e punës së fëmijëve në legjislacion dhe politika;
- ndërtimin e kapaciteteve për autoritetet publike, partnerët social dhe shoqërinë civile;
- themelimi dhe drejtimi i Sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve (SMPF);
- shërbimet e drejtpërdrejta për fëmijët të përfshirë në FKPF ose në rrezik të përfshirjes në FKPF;
- ngritja e vetëdijes.

Me ndihmën e ONP-PNEPF, Kosova ka miratuar një Udhëzim administrativ për parandalimin dhe eliminimin e menjëhershëm të punëve të rrezikshme për fëmijët, e cila përcakton sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet që ndalohen dhe mundësojnë mbledhjen e rregullt të dhënave statistike.

Prioritetet e ONP-PNEPF në Kosovë për vitin 2010 janë si në vijim:

- mbështetja e autoriteteve dhe partnerëve social në përpilimin e Planit të veprimit të Kosovës për parandalimin dhe eliminimin e FKPF-së;
- përkrahja e MPMS-së në përpjekjet e saj për shtrirjen e Sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve në gjithë Kosovën për të garantuar një sistem kombëtar të mbledhjes së të dhënave të bazuara në fakte për punën e fëmijëve dhe mekanizmat përkatës për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në lidhje me FKPF-në;
- ofrimi i njohurisë së qëndrueshme autoriteteve publike dhe organizatave të punëtorëve

dhe punëdhënësve mbi konventat kryesore të ONP-së, duke përfshirë ato mbi punën e fëmijëve dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre për pjesëmarrje në formulimin dhe zbatimin e Planit të veprimit të Kosovës, mobilizimi dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes mbi parimet dhe të drejtat themelore të ONP-së në punë, duke përfshirë parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve.


UNICEF-i ka kryer një studim gjithëpërfshirës për punën e fëmijëve në Kosovë. Ky raport analizon karakteristikat kryesore të punës së fëmijëve të grupmoshës 6-15 vjeç (periudha e arsimimit të detyrueshëm në Kosovë), duke përfshirë (i) llojet më të zakonshme të punës së fëmijëve, (ii) kushtet e punës për fëmijët punëtor, (iii) marrëdhëniet ndërmjet punës së fëmijëve dhe situatës financiare dhe (iv) raportin ndërmjet punës së fëmijëve dhe arsimimit. Hulumtimi ka përfshirë intervistat me 354 fëmijëve punëtor të grupmoshës 6-15 vjeç dhe 23 diskutime me fokus grupe me pjesëmarrjen e prindërve, mësuesve, përfaqësuesve të OJQ-ve dhe autoriteteve vendore dhe qendrore.

Disa prej konkluzioneve më të rëndësishme të këtij studimi janë si në vijim:

- Nuk dihet numri i përgjithshëm i fëmijëve që punojnë.
- Fëmijët punëtorë në shumicën e rasteve janë të angazhuar në shitjen e produkteve në rrugë apo treg; ata po ashtu punojnë në shtëpi apo në prodhimtarinë bujqësore (shih Ilustrimin 9 më poshtë)
- Gjysma e fëmijëve që punojnë janë vajza. Mosha mesatare e këtyre fëmijëve është 12.5 vjeç. Mosha mesatare e fillimit të punës është 10 vjeç.
- Fëmijët zakonisht punojnë gjatë verës dhe më pak gjatë dimrit, ndërsa tre nga katër fëmijë punojnë gjatë tërë vitit. Ata punojnë mesatarisht 6 orë në ditë verës dhe 4 orë në ditë gjatë vitit shkollor dhe 6 ditë në javë.
- Gati 15 përqind e fëmijëve ankohen për probleme shëndetësore.
- Gati 45 përqind e familjeve të fëmijëve të intervistuar nuk marrin ndihmë sociale.
- Vijimi i shkollimit është i lartë, megjithatë rreth 87 e tyre vijnë në dy-tri ndërrime në shkolla.
- 13 përqind e fëmijëve që punojnë nuk vijnë kurrfarë shkollimi.
- Fëmijët duhet të punojnë për shkak të disa arsyeve dhe varfëria është arsyeja kryesore.
- Të ardhurat ditore për janë 7 euro në ditë, por vetëm 40 përqind e tyre paguhet.

Në mënyrë që të eliminohet puna e fëmijëve në Kosovë, duhet të ketë një qasje integruese nga aktorët kryesor, si MPMS-ja, Inspektorati i Punës, partnerët social dhe organizatat ndërkombëtare aktive, si ONP-ja, UNICEF-i dhe BE-ja. Përmirësimi i ligjit mbi punën, duke përfshirë Konventën për format më të kwqija të punës së fëmijëve (Konventa nr. 182, 1999) dhe Rekomandimin për format më të kwqija të punës së fëmijëve (Rekomandimi nr. 190, 1999) do të ishte hapi i parë në këtë drejtim.

**Ilustrimi 9. Punët kryesore të kryera nga fëmijët**



---

## 1.9 Statusi shëndetësor

Para vitit 1999, kanë ekzistuar shumë pak mundësi për zhvillimin e një sistemi modern shëndetësor në Kosovë. Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës është themeluar më 1986, duke krijuar klinikat ku personeli mjekësor ka përmirësuar kapacitetet dhe njohuritë e tyre.

Përparim i konsiderueshëm është shënuar në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore që nga lufta e vitit 1999. Një mbështetje e rëndësishme ka ardhur nga donatorët ndërkombëtar dhe buxheti i përgjithshëm. Shumë ndërtesa shëndetësore janë ndërtuar viteve të fundit, duke rezultuar në rritjen e numrit të personelit të kualifikuar dhe numrin e pacientëve të trajtuar në qendrat mjekësore dhe klinikat publike dhe private.


Në mënyrë që të zhvillohet sistemi shëndetësor publik, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) është duke mbështetur programet vijuese:

- Hartimin e strategjive dhe politikave për shëndetin publik, posaçërisht për shëndetin e fëmijëve dhe lehonave, shëndetin mendor, sëmundjet ngjitëse dhe jo-ngjitëse, imunizimin, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, shëndetin mjedisor, programet e zhvillimit të shëndetit dhe ndërtimi i kapaciteteve sa i përket sistemit shëndetësor.
- Fuqizimin e qasjes të bazuar në komunitet ndaj shëndetit mendor.
- Fuqizimin e sistemit shëndetësor publik për të zhvilluar një sistem të paralajmërimit të hershëm për monitorimin, kontrollin dhe reagimin ndaj përhapjes së sëmundjeve ngjitëse.
- Promovimin e qendrave vullnetare për konsultime dhe testim integruar për HIV/AIDS-in në institucionet publike.
- Fuqizimin e kujdesit primar shëndetësor nëpërmjet qasjes së mjekësisë familjare.
- Adresimi i nevojave emergjente shëndetësore në rajonin e Mitrovicës në lidhje me kontaminimin me plumb dhe kontaminimet e tjera me metale të rënda.

Ligji për shëndetësinë (2004/4) përcakton synimet dhe objektivat e sistemit shëndetësor, parimet e kujdesit shëndetësor, institucionet përgjegjëse, sistemin e sigurimit shëndetësor, inspektoratin e shëndetësisë, të drejtat dhe obligimet të sistemit në lidhje me shëndetin publik dhe po ashtu rolin dhe obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH). Komunitet e Kosovës ofrojnë kujdesin parësor shëndetësor, duke i dhënë prioritet parandalimit bazuar në parimin e mjekësisë familjare. Qendrat e kujdesit parësor janë themeluar në 36 komunat e Kosovës. Ndërkohë, qendrat e mjekësisë familjare dhe stacionet e mjekësisë familjare janë themeluar në vendbanimet më të vogla. Kujdesi shëndetësor dytësor ofrohet në spitalet e qendrave urbane dhe në shtatë spitalet rajonale. Këto institucione sigurojnë shërbime të specializuara dhe spitalore. Shërbimet profesionale për kujdes mendor ofrohen nëpërmjet kornizës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor në disa qytete. Kujdesi shëndetësor terciar ofrohet nga ekspertët e specializuar mjekësor të punësuar në Qendrën klinike universitare të Prishtinës.

Përkundër përmirësimeve të fundit në sistemin shëndetësor publik, popullsia e Kosovës ende vuan nga niveli i lartë i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë. Të dhënat nga vizitat mjekësore në qendrat shëndetësore parësore më 2007 tregojnë se sëmundjet më të shpeshta kanë të bëjnë me sistemin e frymëmarrjes, sistemin tretës dhe sistemin e qarkullimit të gjakut, siç edhe shihet në Ilustrimin 10.

**Ilustrimi 10. Sëmundjet më të shpeshta në Kosovë, 2006**



Vdekshmëria e foshnjave në Kosovë ka rënë që nga viti 2000, por ende është më e larta në Evropë me 35 vdekje për 1000 lindje (Raporti për OZHM-të,2002). Kosova po ashtu ka vdekshmërinë më të lartë të nënave gjatë lindjes, gati 23 vdekje për 1000 lindje. Sfidat në këtë fushë janë të lidhura me përmirësimet në shëndetin riprodhues, shërbimet për gratë shtatzëna, të dhënat statistikore, zbatimin e fushave me prioritet Strategjisë për shëndetin riprodhues 2007-2017, zbatimin me prioritet të Ligjit për shëndetin (2006/02-L76) dhe Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë (2008/03-L-110).

---

## 2 Sistemet e sigurimit social në Kosovë

Kjo pjesë përshkruan zhvillimin e sistemit të sigurimit social në Kosovë gjatë periudhës 2001-08 dhe vlerëson gjendjen aktuale. Të dhënat bazike janë marrë nga legjislacioni aktual mbi sigurimin social, statistikat e ESK-së, raportet teknike nga organizatat ndërkombëtare dhe informatat dhe mendimet e përfaqësuesve të departamenteve gjegjëse në MPMS, menaxherët e Fondit të kurtimeve pensionale të Kosovës (FKPK) dhe partnerët social.

### 2.1 Sistemet e pensionit

#### 2.1.1 Pasqyrë

Para vitit 1990, popullsia e punësuar në Kosovë ka qenë e siguruar sipas sistemit të pensionimit të ish Jugosllavi. Shuma e pensionit është përcaktuar në bazë të numrit të viteve dhe kontributit. Zyra autonome e fondit pensional të Kosovës ka qenë agjencia administrative, e cila ka mbledhur kontributet dhe ka paguar beneficionet. Zyra autonome e fondit pensional është mbyllur më 1990 dhe autoriteti i saj është transferuar në Serbi.

Konflikti i armatosur në Kosovë ka rezultuar në shkatërrimin total të sistemit pensional, duke përfshirë sidomos dëmtimin apo humbjen e shënimeve të kontributeve për sistemin e sigurimit pensional. Ka ekzistuar një nevojë urgjente për të reformuar sistemin e sigurimit social për të ofruar të ardhura bazike për tërë popullsinë. Në veçanti, sistemi i ri pensional duhet të përcaktoj pensionet për grupet në vijim:

- Pensionistët ekzistues sipas sistemit Jugosllav të pensionimit, të cilët nuk janë paguar që nga viti 1999.
- Invalidët e luftës, të cilët nuk kanë mbushur moshën e pensionimit por janë të paaftë për të punuar.
- Personat e papunë, të cilët kanë humbur punën për shkak të luftës apo procesit të privatizimit.

Më 2001, UNMIK-u në bashkëpunim me disa organizata ndërkombëtare filloi krijimin e sistemit të ri pensional në Kosovë, brenda kornizës së stabilizimit dhe reformave integruese. Si pasojë, sistemi pensional në Kosovë është reformuar në pajtim me strukturën tri shkallësh në vijim:

- (1) Pensioni bazë për të gjithë banorët e Kosovës (shkalla e parë);
- (2) Kursimet pensionale të obligueshme për punëtorët (shkalla e dytë);
- (3) Pensionet plotësuese vullnetare (shkalla e tretë).

Rregullorja 2001/35 për Pensionet në Kosovë ofron kornizën themelore legjislative për sistemin aktual të pensioneve në Kosovë. Kjo rregullore është ndryshuar dhe plotësuar më 2005 sipas Rregullores 2005/20.

Ligji për metodologjinë për caktimin e lartësisë së pensionit bazë në Kosovë (2002/1) përcakton metodologjinë për caktimin e nivelit të pensionit bazë për çdo vit. Ky ligj po ashtu përcakton institucionet përgjegjëse për vlerësimin e vlerës së mallrave të zgjedhura, të cilat përbushin nevojat themelore për konsumim ditor të 2100 kalorive për person.

Ligji për pensionet për personat me aftësi të kufizuar apo personat plotësisht të kufizuar (2003/23) në Kosovë përcakton kriteret e përzgjedhjes, procedurat për konfirmimin e paaftësisë, rolin dhe obligimet e komisioneve mjekësore, shumën e pensionit dhe rregullat për administrimin e buxhetit.

## 2.1.2 Pensioni bazë – shkalla e parë

### (1) Mbulimi

Sistemi i pensionit bazë mbulon të gjithë qytetarët me banim të përhershëm në Kosovë. Pensioni është i normës fikse dhe financohet nga buxheti i përgjithshëm.

Pensionin bazë për të moshuarit u paguhet personave mbi 65 vjeç. Në dhjetor 2008, 138,847 individë apo 6.4 përqind e popullsisë kanë marrë pensionin.

Pensionin bazë invalidor përfshin personat e moshës 18 deri 65 vjeç. Vendimet mbi përzgjedhjen merren nga komisionet mjekësore të krijuara nga MPMS-ja. Pensionin bazë invalidor nuk paguhet nëse shfrytëzuesi pranon pension nga skema e veteranëve të luftës apo asistencë sociale, si anëtar që varet nga familja. Në fund të vitit 2008, 19,746 individë apo 0.9 përqind e popullsisë kanë marrë këtë beneficion.

Futja në funksion e pensionit bazë universal dukshëm ka rritur numrin e pensionistëve. Më 1998, numri i përgjithshëm i pensionistëve ka qenë 82,203, që është barasvlershëm vetëm për 52 përqind të shifrës së paraqitur më 2008.

### (2) Pensionet

Më 2008, pensionin bazë mujor ka qenë €40 për pensionistët e moshuar dhe €45 për personat me aftësi të kufizuar. Sipas Ligjit për metodologjinë për caktimin e lartësisë së pensionit në Kosovë (2002/1), niveli i pensionit bazë përcaktohet në bazë të shportës së ushqimit, e cila mbulon nevojat minimale ditore, barasvlershëm me 2100 kalori. Në dhjetor të secilit vit, MEF-i vlerëson vlerat e referuara të mallrave në shportën e ushqimit dhe përcakton nivelin e pensionit bazë për vitin e ardhshëm, në pajtim me kufizimet e buxhetit të përgjithshëm.

Shuma mujore e pensionit bazë për personat e moshuar ka qenë 28 euro në vitin 2002, 35 euro më 2003 dhe ka mbetur në 40 euro nga 2004 deri më 2008. Ndërsa paga mujore mesatare më 2008 ka qenë 237 euro në sektorin publik dhe 248 euro në sektorin privat, pensionin bazë është i barabartë me vetëm 16 apo 17 përqind të pagës mesatare<sup>3</sup>. Meqenëse shuma mujore e pensionit bazë nuk ka qenë indeksuar nga 2004 deri 2008, niveli i tij është zvogëluar në raport me pagën mesatare. Më 2002, pensionin bazë ka qenë i barabartë me 20 përqind të pagës në sektorin publik por vetëm 16 përqind më 2008.

Tabela 7 krahason pensionin bazë me BPV-në për kokë banori nga viti 2004 deri më 2008. Ngjashëm, pensionin bazë për të moshuarit sipas BPV-së për kokë banori është zvogëluar nga 33 përqind më 2004 në 29 përqind më 2008.

**Tabela 7. Përfitimet e pensionit dhe të ardhurave për kokë banori, 2004-08**

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
Pensionin bazë (€/viti)	480	480	480	480	480
BPV për frymë (€/viti)	1,473	1,482	1,520	1,612	1,674
Pensionin / BPV për kokë banori	33%	32%	32%	30%	29%

Burimi: ESK 2009

<sup>3</sup>Duhet të theksohet se që nga viti 2008, skema pensioneve favorizuese është zbatuar për të mundësuar një pension shtesë prej 35 euro për pensionistët të cilët kanë kontribuar në ish sistemin pensional (për më shumë hollësi, shih pjesën e ardhshme). Nëse kjo shumë shtohet, pensionin paraqet 30-32 përqind të pagës mesatare.

Shuma mujore për pensionin bazë invalidor përcaktohet në mënyrë të ngjashme me pensionin për personat e moshës së vjetër. Pensionet invalidore paguhen nëse parashtruesi përmbush të gjitha kriteret ligjore për konfirmimin e aftësisë së kufizuar dhe certifikimit nga komisioni mjekësor.

### (3) Pensioni favorizues

Në bazë të vendimit 13/277 (31.10.2007), i ashtuquajturit Skema e sigurimit të pensionit favorizues është zbatuar nga viti 2008. Kjo skemë siguron një pension shtesë për qytetarët e Kosovë mbi moshën 65 vjeç, nëse ata mund të dëshmojnë se kanë qenë pensionistët apo kanë paguar kontribute për së paku 15 vite nën sistemin e mëhershëm. Shuma mujore e pensionit është norma fikse prej 35 euro, e cila paguhet si shtesë nga pensionit për personat e moshës së vjetër.

Departamenti i administratës pensionale (DAP) vlerëson se 28,135 pensionistë, që përfaqësojnë rreth 20 përqind të të gjithë pensionistëve të moshës së vjetër, kanë marrë këtë lloj pensioni në janar 2009. Vlerësohet se numri i shfrytëzuesve të kësaj skeme do të rritet në të ardhmen.

### (4) Shpenzimet për pensionet dhe financimi

Tabela 8 tregon numrin e pensionistëve dhe shpenzimet në lidhje me pensionin bazë për personat e moshës së vjetër për periudhën 2005-08. Numri i pensionistëve është rritur gradualisht. Duke qenë se pensioni bazë nuk është indeksuar për periudhën e lartpërmendur, transaksionet buxhetore tregojnë një rënie të lehtë në BPV.

**Tabela 8. Numri i pensionistëve dhe shpenzimet për pensionet (pension bazë për personat e moshës së vjetër), 2005-08**

Viti	2005	2006	2007	2008
Numri i pensionistëve	124,893	127,356	131,875	138,847
Pensionistët/popullsia (%)	6.03	6.06	6.19	6.42
Transaksioni buxhetor (milion €)	60.52	64.29	63.82	65.75
Transaksioni buxhetor (% të BPV)	2	2	1.9	1.8

Burimi: FKPK 2009

Tabela 9 paraqet shpenzimet për pensionin bazë invalidor për periudhën 2004-08. Numri i shfrytëzuesve ka rënë nga 21,150 më 2005 në 19,746 më 2008 dhe në 18,091 në prill 2009. Më 2008, shpenzimet për In 2008 shpenzimet për pensionin bazik invalidor kanë rënë për 28.8 përqind krahasuar me vitin paraprak. Kjo rënie pasqyron shtrëngimin e rregullave për fitimin e së drejtës në këtë lloj pensioni.

**Tabela 9. Shpenzimet e pensionit (pension bazë invalidor), 2004-08**

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
Transaksioni buxhetor (milion €)	12.8	12.8	15.3	13.4	10.4
Transaksioni buxhetor (% të BPV)	0.4	0.4	0.5	0.4	0.3

Burimi: DAP 2009

Pensionet bazë dhe pensionet favorizuese janë të financuara nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. DAP-i dhe MEF-i janë përgjegjës për përgatitjen e buxhetit në lidhje me pensionet.

Tabela 10 paraqet shpenzimet e përgjithshme për pensione, të shprehura në përqindje të BPV-së.

Kryesisht për shkak të futjes së pensionit favorizues (shpenzimet e vlerësuara më 2008 ishin 31.5 milion euro), shpenzimet e përgjithshme për pensione janë rritur për 39 përqind më 2008.

**Tabela 10. Shpenzimet e përgjithshme për pensione, 2004–08**

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
Transaksioni buxhetor (milion €)	56.06	73.32	79.59	77.22	107.65
Rritja e përqindjes		31%	9%	-3%	39%
Transaksioni buxhetor (% të BPV)	1.9	2.4	2.5	2.2	3

Burimi: DAP 2009

## (5) Administrata

Skema e pensionit bazë administrohet nga Departamenti i administratës pensionale (DAP) në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. DAP-i është themeluar në dhjetor të vitit 2003. DAP-i përbëhet prej tri divizioneve: Divizioni i skemave pensionale, Divizioni i pagesave të skemave pensionale dhe Divizioni i sigurimeve pensionale-invalidore.

Pensioni bazë u paguhet pensionistëve nëpërmjet transaksionit bankar. DAP-i hap një xhirollogari bankare për pensionistin tek një bankë komerciale, të zgjedhur nga vetë pensionisti. Si pagesë administrative, banka pranon 5 euro për çdo vit për secilën xhirollogari bankare nga buxheti i konsoliduar. Këto banka mbikëqyren nga Departamenti i thesarit i MEF-it. Bankat ofrojnë informata për pensionet individuale nëpërmjet shërbimeve të tyre elektronike. Kjo metodë e pagesës elektronike u mundëson atyre të transferojnë pensionet në mënyrë të sigurt dhe efektive në aspektin e shpenzimeve, edhe pse të dhënat duhet sistematikisht të përmirësohen, azhurnohen dhe mbikëqyren.

Një sfidë me të cilën ballafaqohet skema është verifikimi i rregullt dhe efikas i statusit të pensionistëve; në Kosovë nuk ekziston një sistem zyrtar i regjistrimit të vdekjeve. Meqenëse xhirollogaritë bankare mund të mirëmbahen me nënshkrimet e dy anëtarëve të familjes, janë paraqitur raste kur anëtarët e familjes vazhdojnë të tërheqin pensionet për pensionistët e vdekur apo të mbijetuarve të tyre.

Fillimisht, MPMS-ja ka kërkuar nga familjet e pensionistëve të vdekur të njoftojnë zyrat e tyre lokale mbi vdekjen e pensionistëve. Megjithatë kjo metodë nuk ka qenë e suksesshme. Prandaj është vendosur që secili pensionist duhet të nënshkruaj një deklaratë bankare për çdo gjashtë muaj. Në rast të dështimit për të siguruar deklaratatë të tilla, DAP-i do të hetoj statusin jetësor të pensionistit.

Për të siguruar përparim të vazhdueshëm në këtë fushë, një kërkesë e veçantë është përfshirë në programet afatmesme buxhetore për përmirësimin e sistemit të teknologjisë informative në bashkërendim me sistemet tjera.

### 2.1.3 Kursimet pensionale të obligueshme – shkalla e dytë

#### (1) Mbulimi

Sistemi i kursimeve pensionale mbulon punëtorët dhe personat e tjerë ekonomikisht aktiv mbi moshën 18 vjeçare. Kontributi është i obligueshëm për punëtorët e lindur pas vitit 1946. Për punëtorët e lindur pas vitit 1946, pjesëmarrja është vullnetare. Tabela 11 tregon mbulimin nga sistemi i kursimeve pensionale.

**Tabela 11. Numri i punëdhënësve dhe punëtorëve në Fondin e kursimeve pensionale të Kosovës, 2002–08**

Viti	Numri i punëdhënësve	Numri i punëtorëve	Rritja (%)
2002	278	87,333	
2003	11,262	144,977	66%
2004	14,993	168,718	16%
2005	18,319	235,420	40%
2006	18,748	235,442	0%
2008	19,500	281,120	19%

Burimi: FKPK 2009

## (2) Pensionet

Sistemi i obligueshëm i kursimeve pensionale siguron pensione për të plotësuar pensionin bazë. Është sistem i bazuar në kontribute. Prandaj edhe lartësia e pensionit varet nga shuma e kontributit të paguar, ndërsa të ardhurat fitohen nga investimi i tyre.

Kur një punëtor arrin moshën e pensionimit – pra moshën 65 vjeçare – nëse kanë akumuluar më shumë se 2000 euro në llogarinë e tyre të kursimeve, atëherë pensioni i paguhet në këste mujore. Nëse bilanci është më pak se 200 euro, atëherë pensioni i paguhet i tëri menjëherë.

Për të siguruar pensionin, bilanci përfundimtar në xhirollogarinë e kursimeve individuale përdoret për blerjen e anuiteteve. Pensioni paguhet deri në vdekjen e pensionistit, pas të cilës kohë i transferohet trashëgimtarëve të kualifikuar për këtë qëllim. Për punëtorët me status martesor është e obligueshme të blejnë një anuitet në pensionin e trashëgimtarëve. Në këtë fazë, shumica e anëtarëve kanë akumuluar kontributet në xhirollogaritë e kursimeve pensionale individuale. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin se pensionistët e parë sipas këtij sistemi pritet të marrin pagesat nga viti 2011, rregullat e hollësishme në fazën e pagesës duhet të përcaktohen dhe informacioni duhet të shpërndahet paraprakisht për t'iu mundësuar punëtorëve për të planifikuar jetën pas pensionimit.

## (3) Kontributet

Burimi kryesor i kursimeve pensionale janë kontributet e obligueshme. Kontributi është caktuar të jetë 10 përqind e shumës së pagës, të ndarë barazi ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve.

Pagesa e kontributeve është e obligueshme për ata të cilët kanë lindur pas vitit 1946. Ky kufizim i moshës është caktuar ashtu që anëtarët e kësaj skeme të mund të kontribuojnë për së paku 10 vite dhe për të akumuluar kursime të mjaftueshme për të blerë anuitete në datën e pensionimit.

Punëtorët e lindur më 1945 apo më herët mund të paguajnë kontributet vullnetare dhe pranojnë pensionet në proporcion me kursimet e tyre. Norma maksimale e kontributit vullnetar është 15 përqind.

## (4) Investimi i fondeve

Kontributet investohen në tregjet ndërkombëtare të kapitalit nga menaxherët e FKPK-së. Përfitimet nga investimet shpërndahen në llogaritë individuale të kursimeve. Të dhënat në vijim tregojnë rritjen e sasisë së asetëve nën kontrollin e FKPK-së për periudhën 2002-2009. Asetet e përgjithshme nën menaxhimin e FKPK-së kanë kapur shumë prej 292 milion euro në maj 2009.

**Tabela 12. Rritja e Aseteve të FKPK-së, 2002–09**


Viti	Asetet (milion €)	Rritja (%)
2002	8.63	
2003	34.8	303%
2004	79.96	130%
2005	141	76%
2006	200	42%
2007	280	40%
2008	240	-14%
Maj 2009	292	22%

Burimi: FKPK 2009

Investimet kanë siguruar norma modeste pozitive të përfitimit deri më 2007. Megjithatë, për shkak të fillimit të krizës financiare globale më 2008, FKPK-ja ka pësuar humbje prej 92.1 milion euro (rreth 29 përqind) të asetëve të saj në investime, e cila ka qenë më shumë se 71 milion euro të kontributeve të mbledhura gjatë atij viti.

FKPK-ja ka investime në 170 kompani ndërkombëtare. Ilustrimi 11 tregon luhatjet e vlerës së aksioneve për 2002-09.

**Ilustrimi 11. Luhatjet e vlerës së aksioneve të FKPK-së, 2002–09**



Nga mesi i vitit 2008 deri në mars 2009, vlera e investimeve të FKPK-së ka rënë vazhdimisht. Megjithatë Këshilli administrativ nuk është mbledhur gjatë kësaj periudhe. Në maj 2009, Këshilli administrativ i FKPK-së ka vendosur se nëse pasqyra e përgjithshme do të jetë më pak se kontributet e përgjithshme (nominale) atëherë FKPK-ja do të kompensoj diferencën.

## (5) Administrata

Fondi i kursimeve pensionale i Kosovës (FKPK) menaxhon sistemin e obligueshëm të kursimeve pensionale. Ky fond është themeluar në gusht 2002 si një subjekt ligjor autonom jofitimprurës. FKPK-ja është përgjegjëse për kontributet dhe investimet dhe garanton kursimet e kontribuuesve. Të gjitha kontributet në llogaritë individuale të kursimeve janë pronë e kontribuuesve dhe nuk mund të përdoren për çfarëdo qëllimi tjetër. Investimet e kursimeve pensionale kryhen nga menaxherët financiar, të caktuar nga Këshilli administrativ.

Këshilli administrativ i FKPK-së përbëhet nga shtatë anëtar, duke përfshirë një përfaqësues të punëdhënësve dhe një përfaqësues të punëtorëve. Së paku katër anëtarë të Këshillit duhet të kenë 10 përvojë profesionale si menaxher financiar ose analist. Këshilli administrativ i FKPK-aë mbledhet sipas nevojës por së paku çdo gjashtë muaj.

---

Administrata tatimore është përgjegjëse për verifikimin e pagesës së kontributeve nga punëdhënësit, përgatitjen e raporteve tremujore mbi kontributet dhe dorëzimin e raporteve të inspektimit mbi pagesat e bëra në llogaritë individuale të kontribuuesve. Administrata tatimore duhet të pranoj dokumentet e punëdhënëseve në lidhje me mbledhjen e kontributeve brenda tri muajve dhe në fund të muajit të katër, duhet të përpiloj raportin tremujor për të dhënat e punonjësit. Administrata tatimore po ashtu ka autoritetin për të zbatuar mbledhjen e kontributeve, nëse vërehet evazioni nga pagimi i tyre.

FKPK-ja ka një sistem të administruar të të dhënave, i cili auditohet financiarisht cdo vit për të vlerësuar saktësinë e informatave, llogarive dhe transaksioneve. Megjithatë disa kontribute dëshojnë të depozitohen në llogaritë individuale të kursimeve pensionale. Kjo ndodh për shkak se disa punëdhënës nuk i dorëzojnë raportet tremujore dhe për shkak të mospërputhjeve ndërmjet pagesave të bëra nga punëdhënësit dhe shumës në deklaratatë. Në fund të vitit 2007, gjithsej 44,500 euro nuk janë depozituar në llogaritë individuale të kursimeve. Si rezultat i përpjekjeve të FKPK-së, shuma e kontributeve të padepozituara është zvogëluar në 28,876 euro deri në mars 2009.

#### **2.1.4 Sistemi pensional vullnetar – shkalla e tretë**

Ky sistem është pension vullnetar privat i organizuar në baza individuale ose nga vetë ndërmarrjet. Ky sistem plotëson sistemin e shkallës së parë dhe të dytë.

Fondet pensionale vullnetare menaxhohen nga Bordi i drejtorëve, i cili ka së paku tre anëtarë. Banka Qendrore e Kosovës rregullon dhe mbikëqyr kompanitë private të cilat ofrojnë sigurime të pensionit vullnetar.

Raportohet se pjesëmarrja në sigurimet e pensioneve vullnetare ka qenë i ulët dhe që deri më sot nuk ka ekzistuar një skemë e tillë pensionale profesionale ose e krijuar nga ndërmarrjet në Kosovë.

#### **2.1.5 Skemat pensionale për grupet e veçanta**

Përveç sistemit pensional që mbulon popullsinë e Kosovës, ekzistojnë skema të veçanta për ish pjesëtarët e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK) dhe ish punëtorët e minierës së Trepçës.

##### **(1) Pensionet për pjesëtarët e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK)**

Ligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (2008/03L-100) rregullon të drejtat për pension të pjesëtarëve aktiv të TMK-së dhe trashëgimtarët e tyre pas shpërbërjes së TMK-së. Kjo skemë ka filluar në janar 2009. DAP-i është në krye të administrimit të këtij procesi. Skema financohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Kushtet për fitimin e së drejtës për këtë pension janë: (i) të kenë arritur moshën 50 vjeçare (me pensionimin të parakohshëm, moshën 45 vjeçare), (ii) të kenë shërbyer për 5 vite në TMK dhe (iii) të kenë qenë pjesëtar aktiv në TMK kur ligji mbi shpërbërjen e TMK-së ka hyr në fuqi.

Shuma e pensionit arrin në 70 përqind të pagës mesatare neto përgjatë tri viteve të kaluara. Pensionimi i parakohshëm llogaritet si 50 përqind e pagë mesatare neto. Në rast të vdekjes së pensionistit, pensioni i tyre pjesërisht trashëgohet nga bashkëshorti/tja apo fëmijët, në raport 60 përqind dhe 20 përqind për secilin. Në prill 2009, 64 pensionistë kanë marrë një pension mujor mesatar në vlerë prej 168 euro.

---

## **(2) Pensionet për ish punëtorët e minierës në Trepçë**

Që nga viti 2004, një skemë e përkohshme për punëtorët minatorë është në funksion. Kjo skemë është themeluar në mënyrë që të zgjidhen problemet sociale si pasojë e ristrukturimit të ndërmarrjeve në kompleksin e Trepçës.

Kushtet për fitimin e së drejtës për këtë pension janë: (i) shfrytëzuesit duhet të jenë të moshës 50 deri në 65 vjeç, (ii) të kenë punuar për ndërmarrjen 10 vite ose më shumë, (iii) nuk janë aktualisht të punësuar ose të vetëpunësuar dhe (iv) nuk marrin ndonjë asistencë sociale. Pensioni përfundon kur shfrytëzuesi arrin moshën 65 vjeçare.

Shuma e pensionit është 80 euro në muaj. Kjo shumë bashkëfinancohet nga buxheti i konsoliduar (50 euro) dhe ndërmarrja (30 euro). Në prill 2009, rreth 4100 persona kanë pranuar pensionin nga kjo skemë. Raportet e revizionit nga DAP-i dhe Administratës tatimore tregojnë se gati 4.5 përqind e shfrytëzuesve kanë humbur të drejtat e tyre sepse nuk i kanë përmbushur kushtet e lartpërmendura.

### **2.1.6 Çështje në lidhje me sistemin aktual pensional**

Analiza jonë ka zbuluar një numër të çështjeve në lidhje me mbulimin e popullsisë dhe përshtatshmërinë e pensioneve të sistemit të obligueshëm pensional.

#### **(1) Pensioni bazë**

Sipas sistemit aktual, pensioni bazë përfaqëson një pension fiks në lartësi për ekzistencë minimale. Qëllimi i tij është të zvogëloj varfërinë tek të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Në krahasim me sistemin e mëhershëm pensional, pensioni bazë ka zgjeruar në mënyrë domethënëse qasjen në përfitimet e pensionit. Në periudhën 1998 deri 2008, numri i pensionistëve gati është dyfishuar.

Për shkak të kufizimeve financiare, niveli i pensionit bazë është mbajtur në një lartësi tepër të ulët. Për më tepër, mungesa e indeksimit në vitet e fundit ka çuar në uljen e fuqisë blerëse të pensioneve bazë. Duke marrë parasysh shpeshtësinë që varfëria tek familjet me anëtarë të moshuar është 62 përqind, përshtatshmëria e pensionit bazë (duke përfshirë metodën e indeksimit) duhet të vlerësohet nëpërmjet një analize të ndikimit të saj mbi uljen e varfërisë tek të moshuarit.

Sistemi pensional ballafaqohet me një sfidë komplekse në lidhje me shënimet të cilat janë humbur gjatë luftës. Në parim, çdo kontribut i bërë në sistemin pensional të mëhershëm duhet të pasqyrohet në shumën aktuale të pensionit. Megjithatë, shpenzimet administrative për të konfirmuar shënimet mbi kontributet e humbura vlerësohen të jenë të mëdha. Skema e pensionit favorizues, që funksionin nga viti 2008, është një zgjidhje e pjesshme ndaj këtij problemi. Megjithatë për shkak të ndërlikimeve të ndryshme administrative, shuma fiks e caktuar është 35 euro në muaj.

Sa i përket pensionit invalidor, duhet të theksohet që skema e pensionit bazë ofron benefite vetëm në rast të paaftësisë së plotë dhe jo në rast të paaftësisë së kufizuar. Është raportuar se kjo mund të ndikojë në vendimin e komisionit mjekësor gjatë vlerësimit të invaliditetit.

#### **(2) Kursimet pensionale**

Kursimet e obligueshme pensionale sigurojnë shkallën e dytë të bazuar në kontributet e akumuluar në llogaritë individuale të kursimeve.

---

Pasi që ky sistem pensional është kontribuues, mbulimi i tij është një çështje kritike. Më 2008, numri i kontribuuesve ka qenë 281,000 apo 58 përqind e popullsisë së punësuar.

Shtrirja e mëtutjeshme e mbulimit ballafaqohet me sfidat në vijim:

- papunësia e lartë dhe ekonomia informale kufizojnë numrin e punëtorëve në sektorin formal të punësimit;
- disa studime kanë gjetur dëshmi të evazionit të pagesës së kontributeve; një raport thekson se 20 përqind e punëtorëve shmangin pagesën e kontributeve për sigurim social;
- kapacitetet e zbatimit janë të dobëta: Agjencisë për inspektimin e punës (AIP) i mungojnë burimet njerëzore dhe financiare dhe po ashtu kapacitetet teknike për të kryer punën në mënyrë efikase; inspektorët e punës e kanë vështirë të zbatojnë vendimet e tyre, për shembull, shqiptimin e gjobave;
- të ardhurat e vogla (ndonjëherë jo-monetare) në sektorin bujqësor – që përfaqësojnë 21 përqind të popullsisë së punësuar – kanë rezultuar në një shumë të parëndësishme të kontributeve: ky sektor është shumë i subvencionuar.

Nëse situata nuk përmirësohet, nuk do ketë rritje të konsiderueshme në mbulim nga sistemi i kursimeve pensionale. Nëse vazhdon norma e ulët e mbulimit në planin afatgjatë, shumë njerëz të moshuar pritet mbështeten vetëm në pensionin bazë në të ardhmen.

Më 2008, sistemi i kursimeve pensionale ka përjetuar një ulje substanciale në asetet e investuara. Humbjet tejkalojnë kontributet. Si një masë emergjente, Këshilli administrativ i FKPK-së ka vendosur që ky fond duhet të kompensoj humbjet në parim me vlerat nominale. Një mësim i mësuar nga kjo është se, sipas sistemit të kursimeve pensionale, anëtarët duhet të kenë parasysh rrezikun e investimeve. Prandaj, ky zvogëlim në llogaritë individuale do të rezultojë drejtpërdrejt në pensione më të vogla në të ardhmen.

## 2.2. Ndhimja sociale dhe sistemet e mirëqenies sociale

### 2.2.1 Pasqyrë

Konflikti i armatosur në Kosovë ka rezultuar në kërkesën e pamasë për ndihmë sociale. Në periudhën pas konfliktit, hapat e parë për rikrijimin e sistemit të ndihmës sociale janë ndërmar nga UNMIK-u, me riaktivizimin e Qendrave për punë sociale (QPS). Këto qendra kanë filluar të ofrojnë beneficionet e ndihmës sociale në vitin 2000.

Më 2001, programi i mirëqenies sociale ka mbuluar 53.916 familje me 186.308 anëtarë. Ky program ka paguar beneficionet në shumën prej 60 DM (marka gjermane) deri në 120 DM për familje. Sipas një vlerësimi të Bankës Botërore më 2001, gjysma e popullsisë së Kosovës kanë jetuar nën pragun e varfërisë ndërsa 12 përqind kanë qenë nën pragun e varfërisë ekstreme.

Në shtator 2001, Departamenti i mirëqenies sociale (DMS) është themeluar brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Detyra e DMS-së ka qenë të hartojë politika dhe strategji gjithëpërfshirëse për sistemin e mbrojtjes sociale.

Sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Kosovë përbëhet nga ndihma sociale dhe shërbimet sociale dhe familjare. Ky sistem është themeluar brenda kornizës së legjislacionit në vijim. Beneficionet për invalidët e luftës janë përcaktuar sipas një ligji tjetër.

- Ligji për familjen (2004/32) përcakton parimet themelore të mbrojtjes gjithëpërfshirëse për familjet dhe anëtarët e tyre në Kosovë.
- Skema e asistencës sociale është bazuar në Ligjin për skemën e asistencës sociale (2003/15). Kjo skemë siguron ndihmën financiare ndaj familjeve me të ardhura nën një prag të veçantë, të caktuar nga MPMS-ja dhe MEF-i, dhe ndaj familjeve me anëtarë që kanë nevojë për përkujdesje.
- Ligji për shërbimet sociale dhe familjare (2005/02/L-17) cakton rregullat dhe rregulloret mbi sigurimin e shërbimeve dhe kujdesit social dhe familjar. Këto beneficione ofrohen në formën e përkujdesjes së drejtpërdrejt sociale, këshillave dhe mbështetjes materiale. Ligji po ashtu përcakton se në cilat vende mund të ofrohen shërbimet sociale, që përfshin shtëpitë e qytetarëve, qendrat speciale për kujdes ditor dhe institucionet rezidenciale.
- Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme (2008/03/L-22) rregullon ndihmën për familjen që përkujdesjen për fëmijët me kapacitete të kufizuara fizike dhe mendore deri në moshën 18 vjeçare. Mbështetja materiale është në formën beneficioneve mujore të administruara nga MPMS-ja.
- Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara (2008/03/L-019) siguron rehabilitimin e personave me kapacitete të kufizuara për punë<sup>4</sup>. Ligji po ashtu përcakton rregullat për integrimin e tyre në tregun e punës në pajtim me kushtet e caktuara në legjislacionin mbi punën.

Skema e asistencës sociale dhe shërbimeve sociale dhe familjare është e organizuar në tri nivele: (i) Departamenti i mirëqenies sociale (DMS) në MPMS, (ii) Qendrat rajonale për punë sociale dhe (iii) Qendrat për punë sociale (QPS) në nivel komunal.

DMS është i përbërë nga katër divizione: (i) Divizioni i asistencës sociale, (ii) Divizioni i shërbimeve sociale, (iii) Divizioni i përkujdesjes institucionale dhe (iv) Divizioni i analizave buxhetore dhe Vlerësimit të varfërisë.

Qendrat rajonale për punë sociale janë themeluar në shtatë rajonet e Kosovës nën mbikëqyrjen e DMS-së. Edhe pse në Kosovë menaxhimi i sistemit të mbrojtjes sociale është i centralizuar, janë ndërmarr një numër i masave drejt decentralizimit më të madh, duke transferuar më shumë kompetenca në autoritetet vendore.

Janë 30 QPS në komunat e Kosovës. Këto QPS janë kryesisht përgjegjëse për administrimin e ndihmave sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda rajonit të tyre.

## 2.2.2 Ndhima sociale

### (1) Beneficionet

Ndhima sociale paguhet për familjet me të ardhura të ulëta dhe të cilat përmbushin kushtet për të fituar të drejtën në ndihmë sociale. Shuma mujore llogaritet sipas numrit të anëtarëve të familjes të cilët kualifikohen për këtë ndihmë.

Një kusht i përgjithshëm për ndihmën sociale është se të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë

<sup>4</sup>Kategoritë e personave me kapacitete të kufizuara për punë që klasifikohen sipas shkakut të invaliditetit përfshijnë: invalidët e luftës, invalidët civil të luftës, invalidët nga lëndimet në punë, personat e lindur me paaftësi fizike dhe mendore dhe invalidët nga aksidentet apo sëmundjet.

banorë të përhershëm të Kosovës. Janë dy kategori të familjeve të përzgjedhura, sipas të ardhurave dhe aftësisë për punë.

Kategoria e parë përfshin familjet me të ardhura të ulëta me asnjë anëtar të aftë për punë të punësuar. Kjo kategori e familjeve përbëhet prej: (i) personave mbi moshën 65 vjeçare dhe të papunësuar; (ii) fëmijët nën moshën 15 vjeçare; (iii) fëmijët të cilët vijnë shkollimin dhe janë nën moshën 18 vjeçare; (iv) të rriturit me paaftësi të përhershme për të punuar; (v) prindërit vetëshqyes me fëmijë nën moshën 10 vjeçare dhe pa asnjë të rritur tjetër të aftë për të punuar; (vi) personat të cilët ofrojnë përkujdesje për anëtarët e familjes mbi moshën 65 vjeçare apo anëtarët me paaftësi të përhershme për të punuar; (vii) në vendbanimet rurale, familja që ka në pronësi më pas se gjysmë hektari tokë. Pasi që të dorëzohet kërkesa, zyrtarët e QPS-së vizitojnë dhe intervistojnë familjen për të verifikuar kushtet e tyre të jetesës.

Kategoria e dytë përfshin familjet të cilat kanë anëtarë familje të aftë për punë, por të cilët janë të papunë. Kushtet për kategori të familjeve janë: (i) anëtarët e papunë të familjes janë në kërkim të punës; (ii) familja ka së paku një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo një jetim; (iii) familja nuk merr asnjë ndihmë tjetër publike; (iv) familja nuk ka në pronësi më shumë se gjysmë hektari tokë dhe (v) familja nuk ka në pronësi një automjet, duke përfshirë një traktor apo ndonjë makineri tjetër bujqësore.

Shuma mujore e ndihmës sociale varet nga numri i anëtarëve të familjes. Shuma përcaktohet nga MEF-i dhe MPMS-ja. Për shembull, shumta e ndihmës sociale është 35 euro për një familje me një anëtar dhe 50 euro për një familje me dy anëtarë, e cila rritet nga 5 euro për çdo anëtar shtesë të familjes deri në maksimum 75 euro për një familje me shtatë apo më shumë anëtarë.

Familjet në kategorinë e parë mund të marrin ndihmë sociale për gjashtë muaj të njëpasnjëshëm. Pas gjashtë muajve, nëse situata socio-ekonomike e familjes nuk është përmirësuar, ata mund të aplikojnë prapë për vazhdimin e ndihmës sociale. Familjet në kategorinë e dytë mund të marrin ndihmë financiare për gjashtë muaj sipas kushteve të kategorisë së parë, me një kusht shtesë, d.m.th. që punëkërkuesit pandërprerë të kërkojnë një vend pune. Nëse kushtet e familjes nuk ndryshojnë pas gjashtë muajve, ata kanë të drejtë të aplikojnë prapë për ndihmë sociale.

Ndihma sociale zvogëlohet nëse familja pranon ndonjë të ardhur tjetër, si remitancat apo pensionet nga jashtë. Ndihma sociale suspendohet nëse të ardhurat e shfrytëzuesve kalon nivelin minimal të mbijetesës (shkalla standarde mujore bruto).

## (2) Shpenzimet e ndihmës sociale

Tabela 13 paraqet numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale për periudhën 2006-08.

**Tabela 13. Ndihma sociale: numri i shfrytëzuesve dhe shpenzimet, 2006-08**

Viti	2006	2007	2008
Familjet përfituese	40.569	37.170	34.307
Anëtarët e familjeve përfituese	174.131	161.049	149.227
Madhësia mesatare e familjes	4,29	4,33	4,35
Shpenzimet (milion €)	-	28,03	26,21
Shpenzimet (% e BPV)	-	0,8	0,7
Ndihma sociale mesatare për familje (€/muaj)	-	62,8	63,4
Ndihma sociale mesatare për person (€/muaj)	-	14,5	14,6

Burimi: MPMS 2009

---

Numri i familjeve dhe numri i anëtarëve të tyre ka rënë gjatë kësaj periudhe trivjeçare. Tabela po ashtu tregon rritjen në madhësinë mesatare të familjeve përfituese. Megjithatë, sipas DMS-së, rënia graduale në numrin e përfituesve është për shkak të monitorimit dhe mbikëqyrjes efikase në lidhje me kriteret për të fituar të drejtën në ndihmë sociale se sa për shkak të përmirësimit të kushteve sociale dhe ekonomike të familjeve të varfra në Kosovë.

Më 2008, transaksionet nga buxheti i konsoliduar për skemën e asistencës sociale ka arritur në 26 milion euro krahasuar me 28 milion euro në vitin 2007, që do të thotë një rënie prej 6.3 përqind. Shpenzimet për ndihmë sociale janë 0.7 përqind e BPV-së dhe konsiderohet si shumë e vogël duke marrë parasysh nivelin e lartë të varfërisë në Kosovë.

### 2.2.3 Shërbimet sociale dhe familjare

Fusha e shërbimeve sociale dhe familjare mbulon përkujdesjen e drejtpërdrejt shëndetësor, këshillimin dhe në raste të veçanta, ndihmën materiale për personat në nevojë. Grupet e caktuara të këtyre shërbimeve përfshijnë: (i) fëmijët pa përkujdesje prindërore, (ii) fëmijët që demonstrojnë sjellje antisociale për shkak të marrëdhënieve të trazuar në familjet e tyre, (iii) personat e moshuar të cilët janë të paafte për t'u përkujdesur për vetveten, (iv) personat me aftësi të kufizuara apo me kapacitete tjera fizike të kufizuara, (v) personat me kapacitete të kufizuara mendore, (vi) personat e ekspozuar ndaj rreziqeve si eksploatimi apo abuzimi, dhuna familjare apo trafikimi dhe (vii) personat e varur nga alkooli apo drogat.

Këto shërbime ofrohen nga personeli i shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët janë profesionistë të kualifikuar në fushat e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, të drejtës dhe pedagogjisë. Disa nga shërbimet sigurohen nga organizatat joqeveritare. Këshilli i përgjithshëm i shërbimeve sociale dhe familjare është themeluar për të menaxhuar dhe mbikëqyr personelin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Shërbimet familjare dhe shërbimet e drejtpërdrejta përbëjnë: (i) ndihmën në punët e amvisërisë, si pastrimi dhe gatimi për personat të cilët nuk janë të aftë të kryejnë këto punë për shkak të moshës së tyre, aftësive të kufizuara apo sëmundjeve dhe nuk kanë ndonjë anëtar familje për t'i ndihmuar; (ii) përkujdesjen e drejtpërdrejt të ofruar në shtëpi, që përfshin pastrimin, higjienën personale dhe ndihmën për të lëvizur dhe qëndruar në këmbë për personat të cilët kanë nevojë për një ndihmë të tillë për shkak të moshës së tyre, aftësive të kufizuara apo sëmundjeve dhe nuk kanë ndonjë anëtar familje për t'i ndihmuar; (iii) përkujdesjen dhe shërbimet në qendrat ditore ku personat në nevojë mblidhen së bashku për të ngrënë, t'u ofrohet ndihmë për të mirëmbajtur higjienën personale, marrin pjesë në terapitë e punës dhe përfitojnë çfarëdo forme tjetër të konsultimeve dhe përkujdesjes sociale; (iv) shërbimet për konsultime të specializuara për personat e varur nga alkooli apo drogat dhe personat tjerë me probleme psikologjike dhe sociale; (v) ndihmën në formën e mbështetjes financiare, mbrojtjes në punë dhe konsultimeve me grupet e njerëzve në nevojë apo për kujdestarët për t'iu mundësuar atyre të formojnë grupe vetëndihmëse; (vi) përkujdesja rezidenciale për personat në moshë dhe personat me nevoja të veçanta dhe (vii) çfarëdo shërbimi tjetër në lidhje me përkujdesjen sociale dhe familjare.

MPMP-ja drejton institucione speciale për të ofruar strehim për personat në nevojë apo ofron strehimore emergjente për personat në nevojë. Një institucion special në Shtime trajton të rriturit të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore. Shtëpia e pleqve në Prishtinë strehon 110 persona. Gjithashtu ka institucione rezidenciale të cilat ofrojnë strehim të përkohshëm për jetimët apo fëmijët e braktisur.

Shërbimi social dhe familjar në Kosovë i kushton vëmendje të veçantë fëmijëve pa përkujdesje prindërore për shkak të vdekjes, zhdukjes apo braktisjes ose injorimit të përhershëm të prindërve të tyre për arsye të ndryshme. Edhe pse një përpjekje fillestare është bërë për të siguruar që fëmijët rriten në familjet e tyre biologjike, ku dyshohet se fëmijët vuajnë nga abuzimi fizik apo mendor apo janë në rrezik nga vetë familjet e tyre, një procedure standarde gjyqësore mund të iniciohet nga shtëpia e prindërve apo kujdestarëve dhe për t'i strehuar ata në kushte më të sigurta. Në përgjigje ndaj numrit në ngritje të fëmijëve cilët kanë nevojë për përkujdesje, shumë qendra janë

hapur në bashkëpunim me organizatat e ndryshme joqeveritare për të siguruar strehim afatshkurtër dhe afatgjatë të fëmijëve. Situata e fëmijëve vazhdimisht mbikëqyret nga DMS-ja për të garantuar mbrojtje adekuatë. Për këtë arsye, ndihma e domosdoshme financiare sigurohet për t'i ndihmuar prindërit birësues për të mbuluar shpenzimet e jetës, mjekësore dhe të arsimit për fëmijët.

## 2.2.4 Beneficionet për invalidët e luftës

Ndarazi nga sistemi i mbrojtjes sociale, i cili mbulon të gjithë qytetarët e Kosovës, ekziston një skemë speciale e cila siguron përkrahje për të ardhurat personale për (i) ata të cilët kanë marrë pjesë në luftë dhe kanë mbetur invalidë, dhe (ii) civilët të cilët kanë mbetur invalidë si pasojë e luftës. Sipas kësaj skeme, invalidët e luftës janë të klasifikuar në shtatë kategori, varësisht nga shkalla e dëmtimit trupor.

Pensionimi bazë invalidor është caktuar të jetë 1.4 herë ndaj pagës minimale kombëtare dhe një shtesë prej 30 deri 100 përqind e pensionit bazë, varësisht nga shkalla e dëmtimit trupor. Për më tepër, kujdestarët e paguar caktohen për personat me dëmtime të rënda trupore.

Sipas të dhënave nga ESK-ja, numri i përfituesve më 2008 ka qenë 11,509 (5,035 meshkuj dhe 6,474 femra). Tabela 14 tregon numrin e përfituesve sipas grupmoshës. Prej muajit janar të vitit 2007 deri në dhjetor 2008, numri i përfituesve është rritur me 3,039 persona.

**Tabela 14. Përfituesit e skemës së invalidëve të luftës, 2008**

Grupmosha	<18	18–25	26–35	36–45	46–55	56–65	65>	Ukupno
Aplikantët (A)	130	423	2,881	4,014	3,546	2,755	2,582	16,331
Përfituesit (P)	93	282	1,602	2,614	2,585	2,288	2,045	11,509
Raporti P/A	72%	67%	56%	65%	73%	83%	79%	70%

Burimi: MPMS 2009

Shpenzimet e përgjithshme për skemën e invalidëve të luftës më 2008 kanë arritur në 17.88 milion euro, krahasuar me 9.17 milion euro më 2007 që shënon një ngritje të madhe prej 95 përqind. Nëse vazhdon ky nivel i lartë i shpenzimeve, skema mund të ballafaqohet me sfida serioze financiare në të ardhmen.

**Tabela 15. Shpenzimet për skemën e invalidëve të luftës 2007–08**

Viti	2007	2008
Shpenzimet (milion €)	9.17	17.88
Përfituesit	9,486	11,509
Pensionimi mesatar për person (€/muaj)	80.56	129.46
Shpenzimet (% të BPV)	0.3	0.5

Burimi: MPMS 2009

## 2.3 Sistemi i kujdesit shëndetësor

### 2.3.1 Sistemi publik i kujdesit shëndetësor në Kosovë

Legjislacioni bazë është Ligji për shëndetësi (2004/04), i cili përcakton sistemin e kujdesit shëndetësor, aktivitetet e qendrave të kujdesit shëndetësor (QKSH) dhe financimin e kujdesit shëndetësor. Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë në kujdesin shëndetësor bazuar në parimet e: barazisë, cilësisë, integritetit dhe përgjegjësisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit, financimit të qëndrueshëm, financimit efektiv në aspektin e kostos dhe bashkëfinancimit.

---

Shërbimet e ofruara nga institucionet e kujdesit shëndetësor në Kosovë përfshijnë:

- Kujdesin shëndetësor parandalues,
- Kujdesin shëndetësor riprodhues,
- Kujdesin shëndetësor për pacientët me sëmundje të veçanta,
- Rehabilitimin, dhe
- Hospitalizimin.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) është agjencia kryesore në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të kujdesit shëndetësor. “Strategjia e sektorit të shëndetësisë 2010-14” ka caktuar pesë objektivat strategjike si në vijim:

- 1) zvogëlimin e përgjithshëm të sëmundjeve dhe vdekshmërisë tek popullsia;
- 2) menaxhimin e përmirësuar të burimeve, hapësirave dhe cilësisë së shërbimeve ekzistuese;
- 3) funksionalizimin dhe sigurimin e një sistemi shëndetësor me një infrastrukturë moderne;
- 4) zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi informativ shëndetësor;
- 5) themelimin e një mekanizmi të qëndrueshëm financiar për kujdesin shëndetësor.

Komunat janë përgjegjëse për ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe mbikëqyrjen e statusit shëndetësor të banorëve. Ofruesit kryesor të kujdesit parësor shëndetësor janë si në vijim: qendrat për shërbime të mjekësisë familjare, ambulancat, qendrat për trajtim emergjent, farmacitë dhe qendrat e rehabilitimit.

Kujdesi parësor shëndetësor përbëhet nga shërbimet si më poshtë:

- parandalimi, trajtimi, mjekimi dhe rehabilitimi që kanë të bëjnë me sëmundjet dhe lëndimet;
- edukimi shëndetësor dhe imunizimin;
- përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesi themelor shëndetësor përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- promovimi i shëndetit oral dhe kujdesin stomatologjik;
- kujdesi për shëndetin mendor bazuar në bashkësi;
- rehabilitimi i bazuar në komunitet;
- sigurimi i ujit të pijshëm dhe ushqimit cilësor.

Institucionet të cilat sigurojnë kujdesin dytësor shëndetësor përfshijnë: spitalet, qendrat e diagnostikimit dhe trajtimit, qendrat e shëndetit oral dhe stomatologjik, qendrat e shëndetit mendor, qendrat integruese të bazuara në komunitet dhe qendrat speciale të rehabilitimit.

Institucionet e kujdesit dytësor shëndetësor sigurojnë shërbimet si në vijim:

- Kujdesin shëndetësor jashtë-spitalor: diagnostik, terapeutik dhe rehabilitues;
- Kujdesin shëndetësor spitalor gjatë 24 orëve: diagnostik, terapeutik dhe rehabilitues;
- Edukimin shëndetësor të pacientëve;
- Përkrahjen profesionale për nivelin e kujdesit parësor shëndetësor.

Institucionet e kujdesit terciar shëndetësor ofrojnë shërbime të specializuara dhe kryejnë aktivitete tjera përfshirë edhe arsimimin mjekësor universitar, aktivitetet shkencore dhe kërkimore, dhe aftësimin dhe arsimimin pas-universitar. Aktualisht, Qendra klinike Universitare e Prishtinës është i vetmi institucion i kujdesit terciar shëndetësor në Kosovë.

### 22.3.2 Shpenzimet shëndetësore

Siç tregohet në Tabelën 16, shpenzimet totale për shëndetësinë janë 150.2 milion euro apo 6.6 përqind e BPV-së më 2006. Prej kësaj shume, shpenzimet private përbëjnë 48.5 përqind.

**Tabela 16. Shpenzimet shëndetësore, 2006**

Treguesit	€ (milion)	Përqindja	% BPV
Shpenzimet totale të shëndetësisë	150.2	100.0%	6.6%
Shpenzimet publike	71.8	47.8%	3.2%
Shpenzimet private	72.8	48.5%	3.2%
Ndihma nga donatorët	5.6	3.7%	0.2%

Burimi: Banka Botërore 2008

Shërbimet shëndetësor ofrohen falas në institucionet publike për grupet e veçanta të përcaktuara me ligj, përfshirë fëmijët deri në moshën 15 vjeçare, studentët, personat mbi moshën 65 vjeçare, personat me aftësi të kufizuara dhe shfrytëzuesit e ndihmës sociale.

Megjithatë pacientët duhet të bëjnë pagesa për disa raste. Çmimet zyrtare në qendrat shëndetësore në Kosovë janë të paraqitura në Tabelën 17.

**Tabela 17. Çmimet për shërbimet mjekësore**

Shërbimi/Pagesa	Çmimi në euro	Qendra mjekësore
Kontrolli mjekësor	€2	Qendrat e mjekësisë familjare
ECHO	€5	Spitalet rajonale
ECHO	€10	Qendra Klinike Universitare Prishtinë
Testet diagnostike	€50	Qendra Klinike Universitare Prishtinë

Burimi: MSH 2009

Pacientët duhet t'i paguajnë institucioneve private të barnave dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor. AMSJ-ja e vitit 2000 ka gjetur se shpenzimet mesatare për shëndetësi tek institucionet private janë 1.6 herë më të larta se sa për institucionet publike. Për më tepër, nëse qendrat shëndetësore nuk kanë barna të caktuara në stoqe, atëherë pacientët duhet t'i blejnë ato nga farmacitë private.

Gjithashtu, ekziston praktika e bërjes së pagesa informate mjekëve dhe personelit tjetër mjekësor. Në një anketë më 2003, përafërsisht 53 përqind e shqiptarëve të Kosovës janë përgjigjur se kanë paguar jo-zyrtarisht për shërbimet mjekësore.

Sipas ABEF-së 2005/2006, vlera e shpenzimeve mjekësore në konsumin total familjar arrin nga 4.3 përqind deri në 8.9 përqind, varësisht nga shkalla e të ardhurave personale. Vlera e lartë e pagesave private për shërbimet e kujdesit shëndetësor paraqet një barrë për buxhetet familjare, në veçanti për familjet me të ardhura të vogla. Prandaj, qartazi ekziston nevoja për të themeluar një mekanizëm për akumulimin e rrezikut nëpërmjet sigurimit shëndetësor.

### 2.3.3 Debati mbi paraqitjen e sigurimit shëndetësor

Reforma e mekanizmit financues të përkujdesjes shëndetësore është një ndër prioritetet e politikës shëndetësore në Kosovë. Ekziston nevojë urgjente për të themeluar sistemin e sigurimit shëndetësor në Kosovë.

Ligji për shëndetësinë (2004/04) përcakton se qytetarët e Kosovës duhet të kenë mbulim të sigurimit shëndetësor nëpërmjet skemave private apo publike të sigurimit shëndetësor. Megjithatë për momentin nuk ka sistem të sigurimit shëndetësor në Kosovë. Shkaku kryesor është vështirësia

për të siguruar një bazë të qëndrueshme të kontributeve për sigurimin shëndetësor. Mungesa e burimeve njerëzore dhe kapacitetet e dobëta institucionale përbëjnë edhe një pengesë shtesë.

Më 2007, është miratuar Ligji për sistemin e sigurimit shëndetësor. Ky ligj ka pasur si pikësynim ofrimin e financimit për sigurimin shëndetësor nga tatimi i të ardhurave personale. Por analizat e mëvonshme kanë nxjerrë në pah se mbledhja e tatimeve për sigurimin shëndetësor do të jetë të pamjaftueshme dhe ky ligj është kthyer për rishqyrtim. Strategjia e sektorit të shëndetësisë 2010-14 thekson se Ministria e Shëndetësisë duhet të ndër marr hapa të mëtutjeshëm. Kjo Strategji parasheh miratimin e një ligji të ri mbi sigurimin shëndetësor në shtator 2009 ndërsa zbatimi i tij do të filloj më 2013.

Në një studim mbi financimin e reformave shëndetësore (2008), Banka Botërore ka vlerësuar implikimet e mundshme financiare dhe ekonomike me futjen në funksion të sigurimit social shëndetësor. Tabela 18 përmbledh rezultatet kryesore:

- Bazuar në të dhënat mbi punësimin dhe pagat sipas sektorëve, financimi ipërgjithshëm vlerësohet të jetë 1.1 bilion euro.
- Për të bërë vlerësime reale, shkalla e mbledhjes së kontributeve është supozuar të jetë 100 përqind në sektorin publik, 50 përqind në sektorin privat (jo-bujqësor) dhe 20 përqind në sektorin bujqësor.
- Nëse supozojmë shkallën universale të kontributit në 10 përqind (kjo është më pak se në Maqedoni, Serbi dhe Turqi, por më shumë se në Shqipëri) dhe duke marrë parasysh evazionin në pagimin e kontributeve në sektorin privat dhe atë bujqësor, shuma e kontributit për fondin e sigurimit shëndetësor vlerësohet se mund të jetë 62.2 milion euro.

**Tabela 18. Kontributet e parashikuara për sigurimin shëndetësor (bazuar në të dhënat e vitit 2005)**

Sektori	Publik	Privat	Bujqësor	Totali
Punësimi total	90.313	249.985	67.915	408.213
Përqindja e punëtorëve (%)	22%	61%	17%	100%
Paga mesatare (€/vit)	1.800	3.600	720	
Paga totale (€ milion)	162,6	899,9	48,9	1.111,4
Shkalla e kontributit	10%	10%	10%	
Kontributet e pritura (€ milion)	16,3	90,0	4,9	
Shkalla e mbledhjes	100%	50%	20%	166,7
Kontributet aktuale (€ milion)	16,3	45,0	1,0	62,2

Burimi: Banka Botërore 2008

Si rezultat i futjes në funksion të sigurimit social shëndetësor, shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësor vlerësohet se do të rrite me 10 përqind<sup>5</sup>. Duke marrë parasysh këtë rritje në shpenzimet shëndetësor, kontributet e parapara për sigurimin shëndetësor do të mbulonin afër 40 përqind të shpenzimeve totale për shëndetësinë.

## 2.4 Beneficionet e tjera të sigurimit social

Aktualisht Kosova nuk ka gamën e plotë të skemave të sigurimit social. Për shembull, përveç skemës së sigurimit social shëndetësor, nuk ka skemë të sigurimit në rast të papunësisë, skemat e beneficioneve të lehonisë apo skemë të beneficioneve familjare për fëmijët. Megjithatë për

<sup>5</sup>Përndryshe, nëse pagesat informale për personelin mjekësor zvogëlohen, mund të pritet një kursim prej 12 milion euro.

---

punëtorët disa nga beneficionet sigurohen në bazë të kornizës së Marrëveshjes së përgjithshme kolektive, me një subvencionim të caktuar buxhetor.

Rregullorja 2001/27 “mbi Ligjin themelor të punës” siguron kriteret për fitimin e së drejtës në kompensim në rast të shkëputjes së kontratës së punës.

Marrëveshja e përgjithshme kolektive siguron të drejtën për pushim me pagesë gjatë shtatzënisë dhe perkujdesjes për fëmijët. Në bazë të kësaj, së paku 70 përqind e pagës së punëtorit duhet të paguhet deri në gjashtë muaj. Pagat për tre muajt e parë mbulohen nga punëdhënësi dhe tre muajt tjerë mbulohen nga buxheti i konsoliduar.

Marrëveshja e përgjithshme kolektive po ashtu siguron të drejtën në kompensim në rast të mungesës për shkak të sëmundjes. Për muajin e parë të sëmundjes, humbja e të ardhurave kompensohet plotësisht nga punëdhënësi. Pas muajit të parë të pushimit mjekësor me pagesë punëtorit, në bazë të një çertifikate nga komisioni mjekësor, mund të marr beneficionin për paaftësi të përkohshme për punë, i financuar nga buxheti i përgjithshëm.

---

### 3 Konkluzionet përmbyllëse

Ky raport përmbledh karakteristikat kryesore të sistemeve aktuale dhe të ardhshme të sigurimit social në Kosovë. Shpresojmë se informatat dhe analizat në këtë raport do të jenë baza të përmirësimeve tjera dhe zhvillimit të një sistemi gjithëpërfshirës të sigurimit social në të ardhmen.

Edhe pse një zhvillim i tillë i politikës kërkon më shumë punë teknike, ne do të përmbylлим me konkluzionet e përgjithshme të bazuara në këtë analizë të paraqitur në raport. Këto konkluzione nuk kanë për qëllim të mbulojnë të gjitha aspektet e zhvillimit të ardhshëm të politikave të sigurimit social.

Së pari, është e rëndësishme që politika e sigurimit social të jetë në pajtim me politika në fushat relevante dhe që politikat relevante të mundësojnë krijimin e një ambienti për zhvillimin e sistemeve të sigurimit social. Shembujt e veçantë të bashkërendimit përfshijnë: (i) një politikë për tregun e punës që promovon punësimin dhe nxit ndërrimin nga punësimi informal në atë formal; (ii) një politikë për të promovuar mbledhjen efikase të kontributeve të sigurimit sociale në pajtim me legjislacionin dhe (iii) politika makroekonomike e cila promovon rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Së dyti, është e rëndësishme për të siguruar burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për politikën ekspansioniste, si futja në funksion e skemave të reja, përmirësimi i shkallës së beneficioneve dhe shtrirja e mbulimit të popullsisë. Financimi i sistemeve aktuale të sigurimit sociale mbështetet kryesisht në buxhetin e konsoliduar. Më 2008, transaksionet nga buxheti i konsoliduar për pensionet dhe skemën e ndihmës sociale kanë qenë 163.4 milion euro, që është barabartë me 4.51 përqind të BPV-së. Një burim alternativ, i cili nuk kufizohet nga buxheti i konsoliduar, janë kontributet e mbledhura nga pagat. Megjithatë, siç është vërejtur në sistemin e kursimeve pensionale të obligueshme, Kosova ballafaqohet me sfida serioze sa i përket shkallës së lartë papunësisë, ekonominë informale në rritje dhe tendencën drejt evazionit të pagimit të kontributeve.

Së treti, asnjë zhvillim apo reformë e re nuk mund të zbatohet në mënyrë efikase nëse nuk mbështetet nga përmirësimet tjera në kapacitetet administrative. Në këtë aspekt, ekziston një nevojë e rëndësishme kapitale për ndërtimin e kapaciteteve për të shtuar njohuritë, ekspertizën dhe aftësitë praktike të menaxherëve dhe stafit administrativ. Po ashtu, duhet të ketë përmirësime në strukturën organizative dhe rekrutimin e personelit të specializuar. Bashkërendimi ndërmjet institucioneve gjegjëse dhe zyrave qendrore dhe komunale duhet të fuqizohet.

Së katërti, politika e ardhshme për sigurimin social në Kosovë duhet të përmbush standardet ndërkombëtare të mishëruara në Konventat dhe Rekomandimet përkatëse të ONP-së dhe gjithashtu Direktivat e Bashkimit Evropian. Po ashtu duhet të theksohet që këto standarde ndërkombëtare mund të udhëzojnë në zhvillimin e politikave.

Së pesti, duhet të bërë përpjekje për të fituar besimin e popullsisë në sistemin e sigurimit social. Konsultimet me palët përkatëse të interesuara kanë zbuluar se sistemi aktual i sigurimit social është i papëlqyeshëm nga popullsia sepse konsiderohet si një skemë e huaj, e imponuar nga bashkësia ndërkombëtare. Një zgjidhje afatgjate mund të arrihet nëpërmjet një dialogu dhe politike pjesëmarrëse të mirëfilltë. Në këtë aspekt, duhet të theksohet rëndësia e procesit të politikëbërjes. Në mënyrë që të arrihet një politikë e cila është e pranueshme për të gjithë palët përkatëse të interesuara, një gamë e gjerë e opsioneve duhet të paraqitet, së bashku me vlerësimet për implikimet financiare. Edhe pse sistemi i pensioneve nuk mund të jetë plotësisht imun nga ndikimi politik, administrimi i politikëbërjes së procesit të reformave pensionale mund të përmirësohet nëpërmjet një procesi të politikëbërjes që është transparent, pjesëmarrës dhe i informuar mirë.

---

## Shtojca A

Për qëllime të referencës, kjo Shtojcë paraqet përvojën shqiptare në zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të sigurimit social dhe shëndetësor.

### A.1 Sistemi i sigurimit social në Shqipëri

Sistemi aktual shqiptar i sigurimit social është themeluar në bazë të Ligjit për sigurimin social në Shqipëri (7703/1993). Historikisht, ligji i parë sa i përket mbrojtjes sociale është miratuar më 1927. Një ligj më gjithëpërfshirës mbi sigurimin social, që mbulonte punëtorët në sektorin publik dhe punëtorët e kooperativave bujqësore veçmas është përpiluar më 1947. Më 1966, është miratuar ligji i ri për sigurimin social por nuk është zbatuar në tërësi.

Sistemi aktual i sigurimit social në Shqipëri përbëhet nga katër skema: (i) sigurimi social i obligueshëm, (ii) sigurimi social vullnetar, (iii) sigurimi social plotësues dhe (iv) sigurimi special shtetëror.

Sigurimi social i obligueshëm është jofitimprurëse dhe bazohet në parimin e kontributit, përgjegjësisë individuale për rrezikun dhe solidaritetin ndërmjet gjeneratave dhe mbështetjen sociale.

Sistemi i sigurimit social mbulon beneficionet në vijim:

- për punëtorët: lehoninë, sëmundjet, aksidentet dhe sëmundjet në punë, moshën e vjetër, invaliditetin, mbijetesën dhe papunësinë;
- për punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit: lehoninë, paaftësinë, moshën e vjetër dhe mbijetesën.

Fondi i sigurimit social financohet nga kontributet e punëtorëve, punëdhënësve dhe personave të vetëpunësuar, që arrijnë në 80 përqind të buxhetit të Institutit për sigurim social (ISS) dhe transfereve nga buxheti shtetëror, që arrijnë në 20 përqind të buxhetit total vjetor të ISS-së. Shkalla e përgjithshme e kontributit është 24.5 përqind, ku 15 përqind paguhet nga punëdhënësi dhe 9.5 përqind nga punëtori.

Mosha e pensionimit është 65 vjeçare për meshkujt dhe 60 për gratë, me 35 vjet stazh. Pensioni është shuma e pensionit bazë plus 1 përqind në vjet të pagës mesatare të karrierës së vlerësuar. Pensioni maksimal është caktuar të jetë dyfish në shumën bazë apo 75 përqind për pagës neto mesatare për çdo tri vite të njëpasnjëshme për 10 vitet e fundit të punësimit, e cila prapëseprapë është e ulët.

Në Shqipëri, sisteme të ndara zbatohen për popullsinë urbane dhe rurale. Kjo është kështu për shkak se kapaciteti i tyre kontribuues dallon shumë. Derisa kontributet e punëtorëve urban janë 13 herë më të mëdha sesa të bujqve, raporti i beneficioneve është përafërsisht 2 me 1. Punëtorët rural/bujqit paguajnë një shumë fikse të kontributeve të përcaktuar nga Këshilli i ministrave: një për bujqit e zonave të ulëta dhe një shumë më të ulët për bujqit e zonave malore. Shkalla e sistemit të varësisë është e lartë me 60 shfrytëzues për 100 kontribuues.

Sistemi i sigurimit social menaxhohet nga Institutit për sigurim social (ISS). ISS-i është institucion autonom nën autoritetin e Ministrisë së Financave. Bordi menaxhues i ISS-së përbëhet nga gjashtë përfaqësues nga ministrinë përkatëse, tre përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve dhe tre përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve. ISS-ja ka 36 zyra rajonale dhe të qarkut, të cilat funksionojnë në tërë vendin. Përveç menaxhimit të fondit të pensioneve publike, ISS-ja është përgjegjës për mbledhjen e kontributeve në vendet rurale. Secila familje rurale që ka në pronësi një parcelë toke

---

ka për obligim të paguaj kontributet e sigurimit social për të gjithë anëtarët e saj të moshës së aftë për punë, në mënyrë që të përfitojnë pensionet në moshën e pensionimit.

Problemet kryesore të sistemit Shqiptar të pensioneve mund të përmbliidhet si më poshtë:

- mbulimi joadekuat i personave të moshës së vjetër në të ardhmen për shkak të numrit të vogël të kontribuuesve aktiv sot;
- rënia e shkallës së beneficioneve për shkak të indeksimit të çmimit të pensionit maksimal dhe zhvlerësimi i valutës kombëtare karshi euros;
- deklarimi i ulët i pagave kontribuuese, dhe
- subvencionet e larta për punëtorët rural dhe pensionistët.

Disa fonde private pensionale funksionojnë në vend dhe të cilat ofrojnë sigurim pensional për një numër shumë të kufizuar të qytetarëve.

## A.2 Sistemi i sigurimit shëndetësor në Shqipëri

Sistemi i sigurimit shëndetësor shqiptar është themeluar në bazë të Ligjit për sigurimin shëndetësor në Shqipëri (7870/1994). Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar viteve të fundit. Skema e sigurimit shëndetësor menaxhohet nga Instituti i sigurimit shëndetësor (ISSh), i cili është një institucion publik gjysmë-autonom. Ministri i Shëndetësisë është Kryesues i Bordit menaxhues.

ISSh-ja ka 12 zyra rajonale dhe 22 agjenci. ISSh-ja ka 580 persona të punësuar, 130 të vendosur në selinë qendrore në Tiranë. Përkujdesja parësore shëndetësore ofrohet në 413 qendra shëndetësore, me një personel prej 9,359 persona. Përkujdesja dytësore shëndetësore sigurohet në 39 spitale, me një staf aktiv prej 11,808 persona, përfshirë Qendrën klinike Universitare të Tiranës me 2600 të punësuar. Përveç punëtorëve kontribuues, skema e sigurimit shëndetësor mbulon fëmijët deri në moshën 15 vjeçare, pensionistë dhe personat me aftësi të kufizuara. Të vetëpunësuarit dhe bujqit mund të jenë anëtarë vullnetar të skemës së ISSh-së.

ISSh-ja financohet nga kontributet e personave të siguruar dhe buxhetit shtetëror. Shkalla e kontributit është 3.4 përqind e pagës bruto, e cila ndahet barabartë nga punëdhënësi dhe punëtori. Buxheti i ISSh-së për vitin 2008 24.2 miliard lekë shqiptarë (186 milion euro). Kontributet e përgjithshme më 2008 kanë arritur në 6.3 miliard lekë shqiptarë (48.5 milion euro) apo 25 përqind e shpenzimeve totale përgjithshme. Mbledhja e kontributeve të sigurimit shëndetësor dhe të sigurimit social kryhet nga Drejtoria e përgjithshme e tatimeve, kurse në vendbanimet rurale nga Instituti i sigurimit social.

ISSh-ja po ashtu menaxhon skemat e kthimit të parave për blerjen e barnave, e cila mbulon grupet e rrezikuara si pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, veteranët, gratë shtatzëna, fëmijët dhe personat e siguruar. Shkalla e kthimit të parave është prej 50 deri në 100 përqind të çmimit të barnave. ISSh-ja rregullisht azhurnon listën e barnave esenciale, të cilat kanë përbërë 400 barna më 2009. Kthimi i parave zbatohet nëpërmjet rrjetit të 700 farmacive në tërë vendin, të cilat janë të kontraktuara nga ISSh-ja. Skema e kthimit të parave për blerjen e parave ka një fond prej 4.7 miliardë lekë shqiptar (36 milion euro).

Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sistemi shqiptar i sigurimit shëndetësor janë: rritja e burimeve financiare të caktuara për sistemin shëndetësor, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimit të spitaleve, ulja e nivelit të korrupsionit dhe përcaktimi i çmimeve reale për shërbimet mjekësore.

---

## Shtojca B

### B.1 Referencat

BSPK, 2006, “Ekonomia informale në Kosovë: çfarë roli për sindikatat?”.

Komisioni Evropian, 2008 “Raporti i progresit për Kosovën (sipas Rezolutës 1244/99). Njësiti E 2 i Drejtoratit të përgjithshëm të Komisionit evropian për punësim, çështje sociale dhe mundësi të barabarta, 2008, “Mbrojtja sociale dhe përfshirja sociale në Kosovë (sipas Rezolutës së KS të OKB-së 1244)”, dorëshkrimi i përfunduar në tetor 2008.

ONP, 2009, “Administrimi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri”.

Enti i Statistikave i Kosovës, 2008, “Statistikat e tregut të punës”, 2008.

Enti i Statistikave i Kosovës, 2008, “Kosova në shifra 2008”.

Fondacioni Evropian i Trajnimit, 2009, “Plani për Kosovën 2009”.

MPMS, vite të ndryshme, Raport vjetor.

MPMS, 2008, Përmbledhja e akteve ligjore të MPMS-së.

MSH, 2009, Strategjia e sektorit të shëndetësisë 2010–2014.

UNICEF, 2004, “Puna e fëmijëve në Kosovë: Një studim për fëmijët që punojnë”.

Banka Botërore, 2006, “Rishqyrtim i sigurimeve sociale në Shqipëri”.

Banka Botërore, 2007, “Reforma e sistemit pensional në Kosovë: të arriturat dhe mësimet”.

Banka Botërore, 2008, “Studim për reformën e financimit të shëndetësisë në Kosovë”.

Frashëri, K., 2008, “Historia e Kosovës”.

Malcolm, N., 1998, Kosovo: A Short History, New York University Press.

Vickers, M., 1998, Between Serb and Albanian: A History of Kosovo, Columbia University Press.

Vickers, M., 1999, The Albanians: A Modern History, London: I.B. Tauris.

Faqet e zgjedhura të internetit:

<http://www.unkt.org/>

<http://data.euro.who.int/hfad/>

[http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=344&Itemid=75](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=344&Itemid=75)

<http://www.ks-gov.net/portal/eng.htm>

<http://www.ks.undp.org/>

<http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=2,110>

<http://www.eulex-kosovo.eu/>

<http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,122>

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/KOSOVOEXTN/0,,contentMDK:20629286~menuPK:297777~pagePK:141137~piPK:141127~the-SitePK:297770,00.html#econ>

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/KOSOVOEXTN/0,,contentMDK:21761678~menuPK:297775~pagePK:64027988~piPK:64027986~the-SitePK:297770,00.html>

<http://www.ks-gov.net/ESK/>

[http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Arsimi\\_public\\_parauniversitar\\_2008-09.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Arsimi_public_parauniversitar_2008-09.pdf)

<http://www.unfpakos.org/demographicProfile.htm>

[http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com\\_docman&task=cat\\_view&gid=19&Itemid=8](http://www.ks-gov.net/ESK/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=19&Itemid=8)

www.mshgov-ks.org  
 www.trusti.org  
 www.ilo.org/ilolex  
<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

## B. 2 Legjislacioni përkatës në Kosovë

Lloji i legjislacionit	Numër	Titulli
Rregullore e UNMIK-ut	2001/27	Rregullore për ligjin themelor të punës
Rregullore e UNMIK-ut	2001/35	Rregullore për pensionet në Kosovë
Ligj	2002/1	Ligji mbi metodologjinë për caktimin e lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe për caktimin e datës së ofrimit të pensionit bazë
Ligj	2002/09	Ligji për inspektoratin e punës
Ligj	2003/15	Ligji për skemën e asistencës sociale në Kosovë
Ligj	2003/23	Ligji për pensionet e aftësisë së kufizuar në Kosovë
Ligj	2004/4	Ligji për shëndetësinë
Ligj	2004/32	Ligji për familjen
Ligj	2005/02-L17	Ligji për shërbimet sociale dhe familjare
Ligj	2006/02-L42	Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional
Ligj	2006/02-L76	Ligji për shëndetin riprodhues
Ligj	2008/03/L-017	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi inspektoratin e punës
Ligj	2008/03-L-019	Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
Ligj	2008/03-L-022	Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme
Ligj	2008/03-L-060	Ligji për kualifikimet kombëtare
Ligj	2008/03-L-068	Ligji për arsimin në komunat
Ligj	2008/03/L-084	Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 mbi pensionet në Kosovë
Ligj	2008/03-L100	Ligji për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës
Ligj	2008/03-L-110	Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë

---

### B.3 Konventat përkatëse të ONP

Konventa për sigurimin social (standartet minimale)	C102
Konventa për trajtim të barabartë (sigurimi social)	C118
Konventa mbi beneficionet e personave në moshë të vjetër, invalidëve dhe të mbijetuarve	C128
Konventa mbi diskriminim (në punësim dhe procesin e punës)	C111, R111
Konventa mbi moshën minimale	C138, R146
Konventa për format më të rënda të punësimin të fëmijëve	C182, R190
Konventa për mbrojtjen e lehonisë	C103, R95, C183, R191
Konventa mbi punëtorët me përgjegjësi familjare	C156, R165
Konventa mbi inspektimin e punës	C81
Konventa mbi sigurinë dhe shëndetin në punë	C155

### B.4 Personat e intervistuar

Basri Ibrahim	Departamenti i administratës pensionale (MPMS)
Muharrem Aziri	Departamenti i administratës pensionale
Isuf Ajeti	Departamenti i administratës pensionale
Muhamet Gjocaj	Departamenti i mirëqenies sociale në MPMS
Bajram Kelmendi	Departamenti i mirëqenies sociale
Dëfrim Rifaj	Departamenti për punë dhe punësim në MPMS
Fadil Rracaj	Departamenti për punë dhe punësim
Skender Gashi	Agjencia e inspektoratit të punës në Kosovë
Agim Millaku	Agjencia e inspektoratit të punës
Haxhi Kamberi	Ministria e Shëndetësisë
Arsim Qafdarbasha	Ministria e Shëndetësisë
Bashkim Bellaqa	Departamenti i statistikave sociale në ESK
Ilir Berisha	Departamenti i statistikave ekonomike në ESK
Agron Krasniqi	Trusti i kursimeve pensionale në Kosovë
Flamur Keqa	Oda ekonomike e Kosovës
Haxhi Arifi Kosovës)	Kryetar i BSPK (Bashkimit të sindikatave të pavarura të Kosovës)
Xhafer Xhaferri	Nënkryetar i BSPK
Hasan Abazi	Nënkryetar i BSPK
Bajram Caka	ISKSH Shqipëri
Alfred Topi	Koordinator kombëtar i ONP-së në Shqipëri
Lindita Boshtrakaj	Menaxhere e programit të ONP/PNEPF-së në Kosovë
Eliza Thana	Asistente e programit të ONP/PNEPF-së në Kosovë
Fatmir Burjani	Konsulent i ONP/PNEPF-së për aktivitetet me organizatat e punëtorëve